

**LIGJI Nr. 04/L-029  
PËR PATENTA**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR PATENTA**

**KREU I  
DISPOZITAT E PËRGJITSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Me këtë ligj përcaktohen kushtet dhe procedurat për regjistrimin e patentës, të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi dhe zbatimi i këtyre të drejtave.

**Neni 2  
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Ministria** - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;

1.2. **Ministër** - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë;

1.3. **Zyra e pronësisë industriale (ZPI)** - Zyra e pronësisë industriale të Republikës së Kosovës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë;

1.4. **Konventa e Parisit** - Konventa e Parisit për mbrojtjen e Pronësisë Industriale të datës 20 mars 1883 të ndryshuar në Bruksel më 14 dhjetor 1900, në Uashington më 2 qershor 1911, në Hagë më 6 nëntor 1925 në Londër më 2 qershor 1934, në Lisbonë më 31 tetor 1958 dhe në Stokholm më 14 korrik 1967, e ndryshuar më 28 shtator 1979;

1.5. **Unioni i Parisit** - Unioni i formuar nga Konventa e Parisit;

1.6. **OBT** - Organizata Botërore e Tregtisë;

1.7. **TRIPS - Marrëveshja në lidhje me çështjet tregtare e të drejtave të pronësisë intelektuale** (Shtojca 1C e Marrëveshjes e Marruakëshit që formoj Organizatën Botërore të Tregtisë, që u nënshkrua me Marrëveshjen e Marokos me 15 prill të vitit 1994);

1.8. **Traktati i bashkëpunimit për patenta** - Traktatin e bashkëpunimit për patenta i realizuar në Uashington me 19 qershor 1970, i amendamentuar me 28 shtator 1979, i modifikuar me 3 shkurt 1984, dhe me 3 tetor 2001;

**1.9. Traktati i Budapestit** - Traktati i Budapestit për njohjen ndërkombëtare të depozitës së mikro-organizmave për qëllime të procedurave të patentës, e realizuar në Budapest më 28 prill 1977, e cila është amendamentuar më 26 shtator 1980;

**1.10. Shpikje Bio-teknologjike** - shpikjet që kanë të bëjnë me një produkt, i cili përbëhet ose përmban material biologjik, apo procesin me anë të të cilit prodhohet, përpunohet ose përdoret materiali biologjik;

**1.11. Material Biologjik** - çdo material që përbëhet nga informatat gjenetike dhe që ka aftësi të vetë ri-prodhimit ose të riprodhohet në një sistem biologjik;

**1.12. Varietet Bimor** - çdo bimë të grupuar nën një lloj të vetëm botanik të klasifikimit më të ulët të njohur i cili grupim, pavarësisht nëse plotësohen tërësisht kushtet për pranimin e varietetit bimor mund të:

1.12.1. përcaktohet me shprehjen e karakteristikave që rezultojnë nga gjenotipi i caktuar apo kombinim i gjenotipeve;

1.12.2. dallohet nga çdo grupim tjetër i bimëve duke shprehur së paku njërin prej karakteristikave të lartpërmendura, dhe

1.12.3. vlerësohet si njësi në lidhje me përshtatshmërinë për tu shumëfishuar në mënyrë të pandryshueshme.

**1.13. Procesi për prodhimin e bimëve ose kafshëve** - procesi i cili në thelb është biologjik, nëse përbëhet tërësisht nga fenomeni natyror si kryqëzimi ose seleksionimi.

**1.14. Procesi Mikrobiologjik** - çdo proces që përfshinë, kryhet ose është rezultat i materialit mikrobiologjik.

**1.15. Licencë ekskluzive** –licenca që i jepet vetëm një të licencuari dhe që i heq të drejtën pronarit të një objekti të pronësisë industriale ta përdorë atë, si dhe ta licencojë atë të persona të tjerë;

**1.16. Licencë joekskluzive** - licenca që nuk i heq të drejtën pronarit të një objekti të pronësisë industriale ta përdorë ose ta licencojë atë të persona të tjerë;

**1.17. Certifikata suplementare** - certifikata e mbrojtjes shtesë për produktet farmaceutike dhe produktet bimore;

**1.18. Certifikata e përparësisë** - certifikata më të cilët vërtetohet e drejta e përparësisë së aplikimit për patentë.

### **Neni 3 E drejta për të aplikuar**

1. Aplikimi për patentë mund të depozitohet nga çdo person ose nga çdo ent tjetër, që barazohet me personin juridik. Aplikimi mund të depozitohet edhe nga dy apo më shumë aplikantë të përbashkët.

2. Personat fizik dhe juridik që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës apo nuk kanë seli të regjistruar të biznesit në Kosovë, gëzojnë të drejta të barabarta në mbrojtjen e shpikjes me patentë me personat fizik dhe juridik që kanë vendqëndrim të përhershëm në Kosovë.

3. Të huajt mund të ushtrojnë të drejtat sipas këtij ligji, në procedurat para Zyrës për pronësi industriale, vetëm përmes përfaqësuesve të autorizuar sipas nenit 128 të këtij ligji.

## **KREU II ZYRA PËR PRONËSI INDUSTRIALE**

### **Neni 4 Organizimi**

1. Zyra për pronësi industriale e Republikës së Kosovës, është organ i pavarur administrativ shtetërorë, e themeluar në bazë të ligjit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë - në tekstin e mëtejshëm Zyra dhe është përgjegjëse për mbrojtjen ligjore të shpikjeve, markave tregtare, dizajnëve industriale, emërtimeve të origjinës, treguesve gjeografik dhe topografive të qarqeve të integruara, si dhe çështjet e tjera që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare nënshkruese e të cilave është Republika e Kosovës. Zyra është e pavarur në aktivitetet e saja.
2. Organizimi dhe funksionimi i Zyrës rregullohet me akt nënligjor.

### **Neni 5 Përgjegjësitë e Zyrës**

1. Zyra në veçanti është përgjegjëse për:
  - 1.1. kryerjen e procedurave në lidhje me dhënien e patentave, certifikatave suplementare të mbrojtjes për shpikje, regjistrimin e markave tregtare, dizajnëve industriale, topografit e qarqeve të integruara, emërtimet e origjinës dhe treguesit gjeografik;
  - 1.2. mbajtjen dhe mirëmbajtjen e regjistrave për përfaqësuesit e objekteve të pronës industriale;
  - 1.3. publikimin e një gazete zyrtare, të titulluar Buletini Zyrtar për Pronësinë Industriale në Kosovë, që përmban të dhëna për aplikimin dhe të drejtat e dhëna për pronësinë industriale;
  - 1.4. ofrimin e shërbimeve informuese lidhur me objektet e pronësisë industriale;
  - 1.5. për organizimin e testimit për përfaqësues të autorizuar në fushën e të drejtave të pronësisë industriale;
  - 1.6. përgatitjen e propozimeve për miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore, iniciimin e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të pronësisë industriale;
  - 1.7. përfaqësimin e Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare për pronën industriale.
  - 1.8. realizimin e detyrave tjera që janë nën kompetencë të saj.

### **Neni 6 Shqyrtimi i vendimeve të marra nga Zyra**

1. Kundër vendimeve të Zyrës lejohet ankesa në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të vendimit.
2. Ankesa i drejtohet komisionit që obligohet, të vendosë dhe ta njoftojë palën.
3. Komisioni i shqyrtimit të ankesave formohet me vendim të Ministrit.

4. Kundër vendimit të komisionit mund të parashtrohet padi në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

5. Kompetencat, mandati dhe puna e komisionit rregullohen me akt nënligjor.

### **KREU III LËNDA E MBROJTJES ME PATENTË**

#### **Neni 7 Shpikja e patentueshme**

1. Patenta jepet për çdo shpikje, në çdo fushë të teknologjisë, që përbën risi, hap shpikës dhe që është e zbatueshme në industri.

2. Shpikje sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk konsiderohen:

2.1. zbulimet, teoritë shkencore dhe metodat matematikore;

2.2. krijimet estetike;

2.3. skemat, rregullat dhe metodat për kryerjen e akteve mendore, lojërat ose realizimi i veprimtarive të biznesit, dhe programet për kompjuterë;

2.4. prezantimi i informatës.

3. Objektet ose veprimtaritë e cekura në paragrafin 2. nën-paragrafi 2.3. të këtij neni përjashtohen nga patentueshmëria deri në atë masë në të cilin aplikimi për patentë ose patenta lidhet me vetë këto objekte apo me këto veprimtari.

#### **Neni 8 Patentueshmëria e shpikjeve bio-teknologjike**

1. Patenta jepet për shpikje, nëse plotësohen kërkesat e cekura në nenit 7 paragrafin 1. të këtij ligji, e të cilat kanë të bëjnë me:

1.1. produktin që përbëhet ose përmban material biologjik;

1.2. procesin me anë të të cilit prodhohet, përpunohet ose përdoret materiali biologjik;

1.3. materialin biologjik, i cili është i izoluar nga mjedisi natyror ose prodhohet me anë të një procesi teknik, edhe në qoftë se ka ndodhë më parë në natyrë;

1.4. varietetet bimore ose shtazore, nëse realizueshmëria teknike e shpikjes nuk kufizohet në një varietet të caktuar bimor ose shtazor.

#### **Neni 9 Përjashtimi nga patentueshmëria**

1. Patenta nuk jepet për:

1.1. shpikjet, shfrytëzimi komercial i të cilave mund të jetë në kundërshtim me rendin publik ose moralin; një përdorim i tillë mund të vlerësohet se bie në kundërshtim me to, edhe nëse nuk ndalohej me ligj;

1.2. varietet bimore ose shtazore, apo proceset thelbësore biologjike për prodhimin e bimëve ose shtazëve, kjo dispozitë nuk aplikohet në proceset mikrobiologjike ose produktet e tyre;

1.3. metodat për trajtimin e trupit të njeriut ose kafshëve me anë të kirurgjisë ose terapisë dhe metodave diagnostifikuese, të ushtruara në trupin e njeriut ose kafshëve; kjo dispozitë nuk aplikohet në produktet, në veçanti në substancat ose përbërjen, që përdoren në këto metoda.

1.4. substancat, që përftohen nëpërmjet transformimeve të brendshme nukleare për qëllime ushtarake.

2. Sipas paragrafit 1. nën-paragrafit 1.1. të këtij neni patenta nuk do të jepet për shpikjet bioteknologjike, të cilat në veçanti kanë të bëjnë me:

2.1. proceset e klonimit të qenieve njerëzore;

2.2. proceset për modifikimin e identiteti gjenetik të linjës gjenetike (embrionale) të qenieve njerëzore;

2.3. përdorimin e embrioneve njerëzore për qëllime industriale ose komerciale; dhe

2.4. proceset për modifikimin gjenetik të kafshëve, të cilat mund t'ju shkaktojnë vuajtje kafshëve pa pasur ndonjë dobi të rëndësishme mjekësore për njerëzimin apo për kafshët, si dhe kafshët që janë rezultat i proceseve të tilla.

## **Neni 10**

### **Trupi i njeriut dhe pjesët përbërëse të tij**

1. Trupi i njeriut, në faza të ndryshme të formimit dhe zhvillimit të tij dhe zbulimi i thjeshtë i njëres prej pjesëve përbërëse të tij, përfshirë sekuencën ose një pjesë të sekuencës së gjenit, nuk përbënë shpikje të patentueshme.

2. Elementi i izoluar nga trupi i njeriut, ose që është prodhuar ndryshe me anë të procesit teknik, përfshirë sekuencën ose një pjesë të sekuencës së gjenit, mund të përbëjë shpikje të patentueshme, edhe pse struktura e atij elementi është identike me atë të elementit natyror.

3. Zbatimi industrial i sekuencës apo pjesës së sekuencës së gjenit, me rastin e aplikimit për patentë duhet të zbulohet ashtu siç është dorëzuar fillimisht.

## **Neni 11**

### **Risia**

1. Shpikja konsiderohet e re, nëse nuk bënë pjesë në njohuritë e mëparshme.

2. Njohuria e më përparshme përbëhet prej gjithë asaj që i është vënë në dispozicion publikut në nivel botëror, me anë të përshkrimit të shkruar ose gojor, përdorimit, ose në ndonjë mënyrë tjetër, para datës së dorëzimit të aplikacion për patentë.

3. Njohuri të mëparshme përbëjnë edhe përmbajtja e aplikacionit për patentë kombëtare ashtu siç është dorëzuar, si dhe pas pranimit të Republikës së Kosovës në Traktatin e bashkëpunimit për patenta dhe Konventën Evropiane të patentave, përmbajtja e të gjitha aplikacioneve për patentë ndërkombëtare dhe Evropiane me efekt për Kosovën, datat e dorëzimit të të cilave janë të më hershme se sa data e aplikacionit, të cekur në paragrafin 2. të këtij neni, dhe të cilat janë botuar në këtë datë ose pas kësaj date.

4. Paragrafët 2. dhe 3. të këtij neni nuk përjashtojnë patentueshmërinë - mbrojtjen me patentë e substancës ose përbërjes, e cila bënë pjesë në njohuritë e mëparshme për përdorim në metodat e

cekura në nenin 9 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.3. të këtij ligji, me kusht që përdorimi i saj në metoda të tilla nuk bën pjesë në njohuritë e mëparshme.

5. Paragrafët 2. dhe 3. të këtij neni nuk përjashtojnë patentueshmërinë e asnjë substance ose përbërjeje të cekur në paragrafin 4. të këtij neni për përdorim specifik në metodën e cekur në nenin 9 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.3. i këtij ligji, me kusht që përdorimi i tillë nuk është pjesë e njohurive të mëparshme ekzistuese.

#### **Neni 12**

#### **Shpalosja e shpikjes pa pasoja të dëmshme**

1. Zbulimi i shpikjes sipas nenit 11 të këtij ligji nuk do të merret në konsideratë, nëse kjo ka ndodhur jo më parë se gjashtë (6) muaj para dorëzimit të aplikimit për patentë dhe në qoftë se ka ndodhur ose si pasojë e:

1.1. abuzimit të dukshëm në lidhje me kërkuesit ose paraardhësit e tij ligjor, ose faktit që aplikuesi apo paraardhësit e tij ligjor ka zbuluar shpikjen në një ekspozitë ndërkombëtare zyrtare, ose zyrtarisht të njohur, sipas kushteve të parapara të Konventës për ekspozita ndërkombëtare, me kusht që aplikuesi në momentin e paraqitjes së aplikacionit për patentë tregon, se shpikja është zbuluar në këtë mënyrë, dhe jo më vonë se katër (4) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës, dorëzon një certifikatë përkatëse për këtë qëllim.

#### **Neni 13**

#### **Shkalla e risisë**

1. Shpikja konsiderohet se ka shkallë të risisë nëse nuk është e njohur për personin me njohuri në atë fushë, duke marrë parasysh njohuritë e mëparshme.

2. Nëse vendoset se shpikja përmban shkallën e risisë, përmbajtja e aplikacionit të cekur në nenin 11 paragrafi 3. të këtij ligji, nuk merret parasysh.

#### **Neni 14**

#### **Zbatueshmëria në industri**

Shpikja është e zbatueshme në industri nëse lënda e saj mund të prodhohet ose të përdoret në çdo lloj industrie, përfshirë edhe bujqësinë.

### **KREU IV**

### **SHPIKJET SEKRETE**

#### **Neni 15**

#### **Shpikja sekrete dhe autoriteti kompetent**

1. Shpikja e shpikur nga një shtetas i Republikës së Kosovës mund të konsiderohet shpikje sekrete, në qoftë se ajo ka të bëjë me interesat shtetërore si mbrojtjen kombëtare apo sigurinë e shtetit.

2. Autoriteti kompetent për shpikjet sekrete është Këshilli i Sigurisë së Kosovës (ne tekstin e mëtejme Autoriteti Kompetent) i cili me akte të veçanta përcakton kriteret e veçanta dhe procedurën për shpikje sekrete.

3. Shpikja sekrete përbënë sekret shtetëror.

#### **Neni 16**

#### **Procedura e aplikimit për shpikje sekrete**

1. Aplikimet që kanë të bëjnë me shpikjet e parapara sipas nenit 15 paragrafit 1. të këtij ligji, i dorëzohen Autoritetit kompetent nga Zyra.
2. Nëse Zyra gjatë ekzaminimit të aplikacionit për patentë, konsideron se aplikacioni ka të bëjë me shpikje sekrete, sipas kriterëve të veçanta të përcaktuara nga Autoriteti kompetent sipas nenit 15 paragrafi 2. i këtij ligji ajo e përcjell atë tek Autoriteti kompetent.
3. Aplikacioni i përcjellur tek Autoriteti kompetent, do të ruaj datën e dorëzimit të caktuar nga Zyra.
4. Nëse Autoriteti kompetent me rastin e shqyrtimit të aplikacionit vlerëson se shpikja nuk përbën sekret, aplikacioni kthehet në Zyrë.
5. Nëse autoriteti kompetent, vlerëson se është fjala për shpikje sekrete, ai lëshon vendim dhe e regjistron atë në regjistrin e patentave për shpikje sekrete që mbahet nga ai.
6. Nëse autoriteti kompetent mendon se shpikja nuk është sekrete, procedura do të kryhet nga Zyra dhe në përputhje me këtë ligj.

### **Neni 17 Shfrytëzimi dhe kompensimi**

1. Autoriteti kompetent ka të drejtën ekskluzive për të përdorur shpikjen sekrete.
2. Shpikësi ka të drejtë për kompensim për shpikjen sekrete të mbrojtur, pavarësisht se a është përdorur shpikja apo jo.
3. Shuma e kompensimit e cekur në paragrafin 2. të këtij neni do të përcaktohet në përpjesëtim me vlerën e tregut të shpikjes.
4. Në rast të mos arritjes së marrëveshjes për kompensim, shpikësi, mund të kërkojë nga gjykata kompetente përcaktimin e shumës së kompensimit.

### **Neni 18 Procedura pas dhënies së patentës për shpikje sekrete**

1. Nëse autoriteti kompetent për mbrojtjen kombëtare përcakton se shpikja nuk është më sekret, ai do të përcjell tek Zyra dosjen që ka të bëjë me shpikjen.
2. Zyra me kërkesën e aplikuesit, fillon ose përfundon procedurën e dhënies së patentës për shpikjen e cila nuk është më sekrete.

### **Neni 19 Mbrojtja jashtë vendit**

Personat fizik dhe juridik vendor, mund të kërkojnë mbrojtjen e shpikjes sekrete jashtë vendit vetëm me autorizim të autoritetit kompetent për siguri kombëtare.

## **KREU V E DREJTA PËR PATENTË**

### **Neni 20 E drejta për patentë**

1. E drejta për patentë i takon shpikësit ose pasardhësit të tij ligjor.

2. Nëse shpikja është krijuar nga dy (2) ose më shumë shpikës bashkërisht, e drejta për patentë u takon shpikësve ose pasardhësve të tyre ligjor.

3. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, kur shpikja është bërë në Kosovë si rezultat i kontratës me porosi apo kontratës së punës, e drejta për patentë i takon personit që ka porositur punën ose punëdhënësit, përpos nëse është paraparë ndryshe me kontratë.

4. Nëse dispozitat e paragrafit 3. të këtij neni zbatohen për shpikjen e bërë në zbatim të kontratës së punës në Kosovë, punonjësi që ka bërë shpikjen ka të drejtën e kompensimit nga punëdhënësi varësisht nga vlera ekonomike e shpikjes. Në mungesë të marrëveshjes mes palëve për të caktuar shumën e kompensimit, shuma caktohet nga gjykata kompetente.

5. Aplikuesi konsiderohet se ka të drejtë për patentë përveç nëse është vendosur ndryshe në procedurat gjyqësore.

6. E drejta për patentë mund të bartet.

### **Neni 21 Shpikësi**

Shpikësi është personi që ka krijuar shpikjen gjatë punës së tij kreative. Shpikës nuk konsiderohet personi i cili në krijimin e shpikjes ka ofruar vetëm ndihmë teknike. Zyra nuk verifikon saktësinë e të dhënave të shpikësit.

### **Neni 22 E drejta morale e shpikësit**

1. Shpikësi ka të drejtë morale që të shënohet si i tillë në kërkesën për patentë, në të gjitha dokumentet e nxjerra në raport me dhënien e patentës, në Regjistrin e aplikacioneve në Zyrë dhe Regjistrin e patentave.

2. E drejta morale e shpikësit nuk mund të bartet.

## **KREU VI EFEKTET E PATENTËS**

### **Neni 23 Të drejtat ekskluzive të fituara me patentë**

1. Patenta i jep pronarit të saj të drejtat ekskluzive:

1.1. nëse lënda e patentës është produkt, ndalon palët e treta që pa pëlqimin e pronarit të prodhoj, ofroj për shitje, të shes, të përdor, eksportoj ose importoj dhe të deponoj për qëllime të tilla, produktin e fituar në bazë të shpikjes;

1.2. nëse lënda e patentës është proces, ndalon palët e treta që pa pëlqimin e pronarit të prodhoj, ofroj për shitje, të shes, të përdor, eksportoj ose importoj dhe të deponoj për qëllime të tilla, produktin e fituar direkt nga ai proces.

2. Pronari i patentës ka të drejtë që palëve të treta pa pëlqimin e tij t'u ndaloj ofrimin dhe furnizimin me produktin (substancë, përbërje, pjesë e pajisjes) i cili përbënë element thelbësor të shpikjes së mbrojtur, në qoftë se ofruesi apo furnizuesi është i njohur ose nga rrethanat e rastit do të duhej të dinte që produkti i tillë ka për qëllim vënien në funksion të shpikjes së një personi tjetër.



3. Dispozitat e cekura në paragrafin 2. të këtij neni nuk zbatohen nëse produkti i tillë është lëndë kryesore e një produkti tregtar, përveç kur furnizuesi apo ofruesi shtyn persona të tjerë për të kryer veprimet e cekura në paragrafin 1. të këtij neni.

#### **Neni 24**

#### **Të drejtat ekskluzive të siguruara me patentë në fushën e bio-teknologjisë**

1. Nëse me patentë mbrohet materiali biologjik i cili përmban karakteristika specifike si rezultat i shpikjes, të drejtat ekskluzive të cekura në nenin 23 paragrafët 2. dhe 3. të këtij ligji, zbatohen edhe për çdo material biologjik që rrjedh nga materiali tjetër biologjik nëpërmjet përhapjes ose shumëzimit në një formë identike ose divergjente dhe që posedon karakteristika të njëjta.

2. Nëse me patentë mbrohet procesi që mundëson prodhimin e materialit biologjik që përmban karakteristika specifike si rezultat i shpikjes, të drejtat ekskluzive të cekura në nenin 23 paragrafët 2. dhe 3. të këtij ligji zbatohen edhe tek materiali biologjik që fitohet direkt nga materiali tjetër biologjik nëpërmjet përhapjes ose shumëzimit në formë identike apo divergjente dhe që posedon karakteristika të njëjta.

3. Nëse një produkt përmban ose përbëhet nga informatat gjenetike është e mbrojtur me patentë, të drejtat ekskluzive të cekura në nenin 23 paragrafët 2. dhe 3. të këtij ligji zbatohen për gjithë materialin, përveç trupit të njeriut dhe fazave të ndryshme të formimit dhe zhvillimit ose zbulimit të thjeshtë të njërës prej përbërësve të tij, përfshirë sekuencën ose një pjesë të sekuencës së gjenit, ku përfshihet produkti dhe në të cilën janë informatat gjenetike dhe realizojnë funksionin e tyre.

#### **Neni 25**

#### **Fusha e mbrojtjes**

1. Fusha e mbrojtjes me patentë përcaktohet nga kërkesat patentore të cilat janë pranuar përfundimisht në procedurën e dhënies së patentës, ndërsa përshkrimi dhe vizatimet shërbejnë për të interpretuar kërkesat patentore.

2. Përmbajtja e kërkesave patentore nuk është e kufizuar në mënyrë strikte në formulimin e tyre. Përshkrimi dhe vizatimet merren parasysh vetëm për qëllim të qartësimit të paqartësive në kërkesat patentore.

3. Kërkesat patentore nuk duhet kuptuar si udhëzim që tregon se fusha e të drejtave ekskluzive mund të shtrihet tek lënda për të cilën personi i kualifikuar në fushën përkatëse mund të konsideroj si fushë të synuar të mbrojtjes.

### **KREU VII**

### **KUFIZIMET E EFEKTIT TË PATENTËS**

#### **Neni 26**

#### **Përfshirjet nga e drejta ekskluzive**

1. Të drejtat e fituara me patentë, nuk vlejnë për:

1.1. veprimet në të cilat shpikja shfrytëzohet për qëllime private dhe jo-komerciale;

1.2. veprimet e kryera për qëllim të hulumtimeve dhe për eksperimentet që kanë të bëjnë me lëndën e shpikjes së mbrojtur, përfshirë edhe rastin kur veprimet e tilla janë të domosdoshme për të bërë regjistrimin ose për të marrë autorizimin për vënien në treg të produktit që është medikament i dedikuar për njerëzit apo kafshët ose është produkt mjekësor;

1.3. përgatitjen direkte dhe individuale të medikamenteve në barnatore në bazë të përshkrimit mjekësor dhe veprimet që lidhen me medikamentin e përgatitur në mënyrë të tillë;

1.4. përdorimin e shpikjes së patentuar në ndërtimin ose funksionimin e avionëve ose mjeteve tokësore të shteteve anëtare të Unionit të Parisit ose anëtare të OBT-së, ose të aksesorëve të avionëve apo mjeteve tokësore të tilla, kur ata avion ose makina tokësore përkohësisht ose aksidentalisht hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës.

#### **Neni 27**

#### **E drejta e përdoruesit të mëparshëm**

1. Patenta nuk ka efekt ndaj personit, i cili para datës së dorëzimit të aplikacionit ose para datës së njohjes së të drejtës së përparësisë së aplikimit, ka shfrytëzuar ose prodhuar brenda veprimtarisë së tij ekonomike produktin i cili është lëndë e shpikjes, ose ka bërë përgatitje serioze dhe reale për shfrytëzimin e shpikjes së tillë në Kosovë.

2. Personi nga paragrafi 1. i këtij neni ka të drejtë, që pa pëlqimin e pronarit të patentës të vazhdojë shfrytëzimin e shpikjes deri në atë shkallë në të cilën e ka shfrytëzuar ose është përgatitur për shfrytëzimin e saj deri në datën e dorëzimit të aplikimit për shpikjen e lartpërmendur.

3. E drejta sipas paragrafit 2. të këtij neni mund të bartet ose të trashëgohet vetëm përmes procesit të punës ku është përgatitur ose ka filluar shfrytëzimi i shpikjes.

#### **Neni 28**

#### **Kufizimi i efekteve të patentës në fushën e bioteknologjisë**

1. Të drejtat ekskluzive nga dispozitat e nenit 24 të këtij ligji nuk aplikohen në materialin biologjik të fituar me përhapjen dhe shumëzimin e materialit biologjik i cili në tregun e Republikës së Kosovës respektivisht me pranimin e Kosovës në Bashkimin Evropian, në tregun e ndonjë Shteti të Bashkimit Evropian, është vënë nga ana e pronarit të patentës ose me pëlqimin e tij, me ç'rast përhapja dhe shumëzimi detyrimisht dalin nga zbatimi për qëllimin e të cilit materiali biologjik vihet në treg, me kusht që materiali i fituar më vonë të mos përdoret për përhapje dhe shumëzim të mëtejshëm.

2. Përrjashtim nga neni 24 i këtij ligji, bën shitja ose format e tjera të komercializimit të materialit për përhapjen e bimëve te fermerit nga ana e pronarit të patentës ose me pëlqimin e tij për shfrytëzim bujqësor, përfshirë autorizimin për fermerin që ai të përdor produktin e korrjeve të tija për përhapje ose shumëzim nga ana e tij ose e fermës së tij.

3. Përrjashtim nga neni 24 i këtij ligji, bën shitja ose ndonjë formë tjetër e komercializimit e kafshëve pjellore ose ndonjë materiali tjetër shtazor reprodukues fermerit nga ana e pronarit të patentës ose me pëlqimin e tij, përfshirë autorizimin për fermerin që ai të përdorë blegtorinë e mbrojtur për qëllime bujqësore, përfshirë vënien e kafshëve ose materialit tjetër ri-prodhues në dispozicion për qëllime të kryerjes së aktivitetit të tij bujqësore por jo edhe të shitjes për qëllime të aktivitetit për ri-prodhim komercial.

#### **Neni 29**

#### **Shuarja e të drejtave ekskluzive**

1. Të drejtat ekskluzive të fituara me patentë që kanë të bëjnë me veprimet e kryera në territorin e Kosovës në lidhje me produktin e mbrojtur me patentë, konsiderohen të shuara me vënien e produktit në tregun e Kosovës nga pronari i patentës ose me pëlqimin e tij të shprehur, përveç nëse ekzistojnë shkaqe të tjera ligjore në bazë të të cilave pronari i patentës mund të ndalojë tregtimin e mëtejshëm të produktit.

2. Dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni zbatohen gjithashtu me ndryshimet e nevojshme në të drejtat ekskluzive të dhëna nga certifikata suplementare.

**KREU VIII**  
**PATENTA SI OBJEKT I PRONËSISË**

**Neni 30**  
**Bartja e të drejtës**

1. Patenta mund të bartet tek personat e tjerë.
2. Bartja e patentës regjistrohet në Regjistrin përkatës të Zyrës me kërkesë me shkrim të njëjës prej palëve dhe publikohet.
3. Bartja e të drejtave të patentës do të ketë efekt ndaj palëve të treta vetëm pas regjistrimit në regjistrin përkatës. Megjithatë, para se të regjistrohet bartja, licenca do të ketë efekt ndaj palëve të treta nëse palët e treta kanë pasur njohuri për bartjen.
4. Dispozitat e këtij neni do të zbatohen gjithashtu ndaj ndryshimeve në kontratën mbi bartjen e patentës, si dhe të drejtat e dhëna nga certifikata suplementare.

**Neni 31**  
**Licencimi**

1. Licenca për patentë mund të jepet për tërë territorin e Kosovës apo vetëm një pjesë të tij.
2. Licenca mund të jetë ekskluzive dhe jo - ekskluzive.
3. Pronari i patentës mund të kërkojë kthimin e të drejtave të dhëna me licencë për patentë, nëse i licencuari shkel ndonjë dispozitë të kontratës së licencës në lidhje me kohëzgjatjen e saj, formën në të cilën përdoret patentë, gamën dhe cilësinë e produkteve të prodhuara për të cilat është dhënë licenca nga i licencuari, pa paragjykuar ndonjë procedurë ligjore në bazë të ligjit apo dispozitë të kontratës.
4. Licenca për patentën regjistrohet në regjistër me kërkesën e njëjës prej palëve dhe publikohet.
5. Licenca për patentë do të ketë efekt ndaj palëve të treta vetëm pas regjistrimit në regjistrin përkatës. Megjithatë, para se të regjistrohet bartja, licenca do të ketë efekt ndaj palëve të treta nëse palët e treta kanë pasur njohuri për të.
6. Dispozitat e këtij neni zbatohen gjithashtu me ndryshimet e nevojshme për përfundimin e kontratave të licencës së zbatimit të patentës, si dhe të drejtat e dhëna nga certifikata suplementare.

**Neni 32**  
**Pengu**

1. Patenta mund të jepet si sigurim ose të jetë objekt pengu.
2. Me kërkesën e njëjës nga palët, të drejtat e cekura në paragrafin 1. të këtij neni regjistrohen në regjistër dhe publikohen.
3. Të drejtat e cekura në paragrafin 1. të këtij neni prodhojnë efekte ndaj palëve të treta pasi të regjistrohen në regjistër. Megjithatë, para se të regjistrohen si të tilla, ato do të kenë efekt ndaj palëve të treta nëse palët e treta kanë pasur njohuri për të.

4. Dispozitat e këtij neni zbatohen gjithashtu ndaj ndryshimeve në lidhje me pengun me rastin e kërkesës për patentë si dhe në rastin e të drejtave të dhëna nga certifikata suplementare.

### **Neni 33 Procedura e përmbarimit**

1. Patenta mund të jetë objekt përmbarimi.
2. Gjykata që ekzekuton përmbarimin ndaj patentës njofton sipas detyrës zyrtare menjëherë Zyrën për konfiskimin e patentës me qëllim që kjo të regjistrohet në regjistër dhe të publikohet.
3. Dispozitat e këtij neni aplikohen me ndryshimet e nevojshme në lidhje me përmbarimin me rastin e kërkesës për patentë si dhe në rastin e të drejtave të dhëna me certifikata suplementare.

### **Neni 34 Falimentimi**

Kur patenta, aplikimi për patentë ose certifikata suplementare është pjesë e pronës në proces të falimentimit, personi i emëruar për menaxhimin e pronës në proces falimentimi sipas detyrës zyrtare informon Zyrën për procedurën e falimentimit me qëllim të regjistrimit të saj në regjistër.

## **KREU IX LICENCAT E DETYRUESHME**

### **Neni 35 Procedura për dhënien e licencës së detyrueshme**

1. Fitimi i licencës së detyrueshme realizohet përmes procedurës gjyqësore.
2. Procedura për dhënien e licencës së detyrueshme bëhet me proces gjyqësor kundër pronarit të patentës ose mbajtësit të certifikatës suplementare, në bazë të një aplikimi për dhënien e licencës së detyrueshme. Gjatë procesit gjyqësor, paditësi cekë të gjitha faktet dhe paraqet dëshmitë e nevojshme në të cilat bazohet kërkesa për licencë të detyrueshme. Gjykata vendos për dhënien e licencës së detyrueshme me vendim.
3. Në mungesë të provave kërkesa për licencë të detyrueshme refuzohet dhe të gjitha të drejtat nga patenta i takojnë personit në emër të të cilët është regjistruar patenta në regjistrin e patentave.

### **Neni 36 Dhënia e licencës së detyrueshme**

1. Gjykata mund të jep licencën e detyrueshme për mungesë ose pamjaftueshmëri të shfrytëzimit të patentës, çdo personi që dëshmon se ka aftësi për të shfrytëzuar shpikjen dhe që e dorëzon kërkesën për dhënien e licencës së detyrueshme apo Qeveria e Republikës së Kosovës, nëse pronari i patentës nuk e ka shfrytëzuar shpikjen e mbrojtur me patentë në territorin e Kosovës në kushte të arsyeshme apo nuk ka bërë përgatitje serioze dhe reale për shfrytëzimin e saj.
2. Kërkesa për dhënien e licencës së detyrueshme sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të dorëzohet pas kalimit të periudhës prej katër (4) viteve pas datës së dorëzimit të kërkesës për patentë apo tri (3) viteve nga data në të cilën është dhënë patenta.

3. Licenca e detyrueshme nuk mund të jepet nëse pronari i patentës dëshmon se ka pasur arsye të bazuar për mos-shfrytëzimin ose pamjaftueshmërinë e shfrytëzimit të shpikjes së mbrojtur.

4. Në bazë të kërkesës gjykata mund t'i jap licencë të detyrueshme për patentën e parë, pronarit të patentës ose pronarit të drejtave për varietet bimor, i cili nuk mund të shfrytëzoj patentën e tij apo patentën e dytë ose të drejtën për varietetin bimorë, pa e shkelur patentën e parë, me kusht që shpikja e deklaruar për patentën e dytë ose varietetin e mbrojtur bimor, përfshinë avancim të konsiderueshëm teknik me rëndësi të konsiderueshme ekonomike, në raport me shpikjen e deklaruar në patentën e parë.

5. Gjykata mund të marrë çfarëdo mase që e konsideron si të dobishme për të verifikuar ekzistencën e një gjendjeje të tillë.

6. Në rastin e licencës së detyrueshme sipas paragrafit 4. të këtij neni, pronari i patentës së parë ka të drejtë që të marr një licencë reciproke në kushte të arsyeshme për të përdorur shpikjen e mbrojtur nga patenta e dytë ose varieteti i mbrojtur bimor.

7. Gjykata mund të jap licencë të detyrueshme nëse shfrytëzimi i shpikjes së mbrojtur me patentë është i nevojshëm në situatë të jashtëzakonshme - siguri kombëtare, mbrojtja e interesit publik në fushën e shëndetësisë, furnizimit me ushqim, mbrojtja dhe përmirësimi mjedisor, interesat specifike komerciale ose kur është e nevojshme që të përmirësohet një praktikë që është përcaktuar si kundër konkurrencës me procedurë gjyqësore apo administrative.

8. Licenca e detyrueshme mund të jepet vetëm nëse personi që ka bërë kërkesë në gjykatë dëshmon se para kërkesës ka bërë përpjekje për të marrë autorizimin apo licencën nga pronari i patentës në afat dhe kushte të arsyeshme të tregut dhe nëse përpjekjet e tilla nuk kanë qenë të suksesshme në periudhë të arsyeshme kohore. Gjykata mund të marr te drejtat në bazë të këtyre kushteve apo në situatat te parapara në paragrafin 7. të këtij neni. Pronari i patentës do të informohet për dhënien e licencës së detyrueshme në afatin më të shkurtër kohor.

### **Neni 37**

#### **Kushtet në të cilat jepet licenca e detyrueshme**

1. Licenca e detyrueshme nuk është ekskluzive, fusha dhe kohëzgjatja e përdorimit kufizohet ekskluzivisht për qëllimin për të cilin është dhënë.

2. Licenca e detyrueshme bartet vetëm në punëtorinë e prodhimit gjegjësisht pjesët e saj, për të cilën është lejuar shpikja dhe e njëjta është shfrytëzuar.

3. Licenca e detyrueshme jepet me qëllim të furnizimit të tregut vendor përveç nëse është e domosdoshme për të përmirësuar praktikën për të cilën me procedurë gjyqësore ose administrative është përcaktuar se kjo praktikë është në kundërshtim me konkurrencën në treg.

4. Gjykata, me kërkesë nga personi i interesuar, anulon licencën e detyrueshme duke përcaktuar mbrojtje adekuatë të interesave legjitime personit të licencuar, nëse rrethanat që kanë shpie drejt dhënies se licencës së detyrueshme, nuk ekzistojnë më dhe nuk ka gjasa që të rishfaqen.

5. Pronari i patentës ka të drejtë në kompensim, në bazë të vlerës ekonomike të licencës.

6. Licenca e detyrueshme, sipas neni 36 paragrafi 4. i këtij ligji nuk bartet përveç me bartjen e patentës së dytë ose varietetit të mbrojtur bimor.

### **Neni 38**

#### **Licencat e detyrueshme për patentë të produkteve farmaceutike që synohen për eksport në vendet që kanë probleme me shëndetin publik**

1. Gjykata mund t'i japë çdo personi, në bazë të kërkesës në pajtim me dispozitat e këtij ligji, licencë të detyrueshme për patentë ose certifikatë suplementare me qëllim prodhimin dhe shitjen e produkteve farmaceutike, kur produktet e tilla janë të destinuara për eksport në vendet importuese që kanë probleme të shëndetit publik. Kur të vendoset për dhënien e një licence të detyrueshme gjykata merr parasysh në mënyrë të veçantë, nevojën për të zbatuar Vendimin e miratuar nga Këshilli i Përgjithshëm i OBT-së, të datës 30 gusht 2003 për zbatimin e paragrafit 6. të Deklaratës së Doha-s për Marrëveshjen e TRIPS dhe Shëndetit Publik - në tekstin e mëtejme: Vendimi i 14 nëntorit 2001.

2. Produkti farmaceutik i cekur në paragrafin 1. të këtij neni, është çdo produkt i industrisë farmaceutike, përfshirë produktet mjekësore për njerëz, që përbëhet nga çdo substancë apo kombinim të substancave të destinuara për trajtimin apo parandalimin e sëmundjeve tek njerëzit, dhe çdo substancë apo kombinim i substancave, të cilat mund t'u jepen qenieve njerëzore me qëllim përmirësimit apo modifikimit të funksioneve fiziologjike apo për të bërë një diagnozë mjekësore, duke përfshirë përbërësit aktiv dhe mjetet diagnostifikuese jashtë organizmit - ex - vivo.

3. Vendi importues i cekur në paragrafin 1. të këtij neni do të jetë çdo vend në të cilën produkti farmaceutik eksportohet. Vendi importues mund të jetë:

3.1. çdo vend i pa zhvilluar, i paraqitur si i tillë në listën e shteteve të Kombeve të Bashkuara;

3.2. çdo anëtar i OBT-së, përveç vendeve anëtare të pa zhvilluara të cekura në nën-paragrafin 3.1 të këtij paragrafi, i cili e ka njoftuar Këshillin për TRIPS për synimin tij që të përdor sistemin e importit duke përdorur këtë sistem në tërësi ose në mënyrë të kufizuar;

3.3. çdo vendi që nuk është anëtar i OBT, por është në listën e vendeve për dhënien e ndihmës nga Komiteti i OECD, si vende me të ardhura të ulëta dhe ka njoftuar Zyrën për synimin e saj që të përdor sistemin si importues në tërësi ose në mënyrë të kufizuar;

3.4. çdo vend anëtar i OBT-se i cili ka bërë deklaratë se nuk do të përdorë sistemin importues, nuk ka të drejtë për importin e tillë.

4. Vendet importuese të pa zhvilluara apo në zhvillim, të cilat nuk janë anëtarë të OBT-së, e të cilat kanë të drejtë sipas paragrafit 3. të këtij neni duhet të plotësojnë kërkesat shtesë.

5. Vendi importues njofton direkt Zyrën në bazë të vendimit.

6. Vendi importues deklaron në njoftim se do të përdorë sistemin për tejkalimin e problemeve të shëndetit publik dhe jo për qëllime industriale apo tregtare dhe miraton masat e cekura në paragrafin 4. të vendimit.

7. Gjykata me kërkesën të bartësit të së drejtës ose nga Zyra, anulon licencën e detyrueshme, në qoftë se vendi importues ka dështuar të përmbushë detyrimet e tij të cekura në paragrafin 2. të këtij neni.

### **Neni 39**

#### **Procedura për dhënien e licencës së detyrueshme për patentat e produkteve farmaceutike që synohen për eksport në vendet që kanë probleme me shëndetin publik**

1. Kërkesa për dhënien e licencës të detyrueshme për patentat e produkteve farmaceutike që synohen për eksport në vendet që kanë probleme me shëndetin publik, i parashtrohet gjykatës në pajtim me dispozitat e nenit 35 të këtij ligji, në qoftë se në territorin e Kosovës është një patentë ose një certifikatë suplementare, efekti i së cilës mbulon veprimtarinë e prodhimit dhe shitjes për qëllime të eksportit.

2. Kërkesa e parashtruar në gjykatë duhet të përmbaj:

2.1. informatat në lidhje me kërkesat për licencë të detyrueshme, të paraqitura në vende të tjera për të njëjtin produkt, me të dhënat për sasi të përkatëse dhe vendet importuese, informatat lidhur me aplikantin për licencën e detyrueshme dhe përfaqësuesin e tij nëse ka;

2.2. emrin kimik të produktit farmaceutik, të cilin ka për qëllim ta prodhojë me licencën e detyrueshme;

2.3. sasinë e produktit farmaceutik, që ka për qëllim të prodhojë me licencën e detyrueshme;

2.4. vendin importues;

2.5. dëshminë e negociatave paraprake me bartësin e të drejtës së patentës apo pronarin e saj në pajtim me dispozitat e paragrafit 5. të këtij neni;

2.6. dëshminë për kërkesë të veçantë nga përfaqësues i autorizuar i vendit importues, apo një organizatë jo-qeveritare që posedon autorizim zyrtar të një ose më shumë vendeve importuese, organeve tjera të KB-së apo organizatave tjera ndërkombëtare shëndetësore që veprojnë me autorizim formal të një ose më shumë vendeve importuese, duke përcaktuar sasinë e produktit të nevojshëm.

3. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për dhënie të licencës së detyrueshme, gjykata do të verifikojë në veçanti:

3.1. nëse secili vend importues i cekur në kërkesë, i cili është anëtar i OBT, ka bërë një njoftim në OBT në bazë të vendimit, respektivisht çdo vend importues i cekur në kërkesë, i cili nuk është anëtarë i OBT, ka bërë njoftim tek Zyra në pajtim me dispozitat e këtij neni në lidhje me secilin prej produkteve të mbuluara nga aplikimi;

3.2. nëse sasia e përcaktuar në kërkesë nuk kalon sasinë e lajmëruar në OBT dhe Zyrë nga vendi importues.

3.3. nëse duke marrë parasysh licencat e tjera të detyrueshme të dhëna në ndonjë vend tjetër, sasia e përgjithshme e produktit, e autorizuar që të prodhohet për cilindo vend importues nuk tejkalon shumë sasinë e lajmëruar në OBT, respektivisht në Zyrë.

4. Informatat e cekura në paragrafin 3. të këtij neni, do të ofrohen dhe prezantohen në kërkesë nga subjekti që kërkon marrjen e licencës së detyrueshme.

5. Licenca e detyrueshme jepet vetëm nëse kërkuesi dëshmon se ka bërë përpjekje për të marrë autorizim nga pronari i patentës për shfrytëzimin e shpikjes së mbrojtur në afate dhe kushte të arsyeshme tregtare dhe në qoftë se përpjekjet kanë rezultuar të pasuksesshme brenda një afati të arsyeshëm. Kjo dispozitë nuk do të aplikohet në situata të jashtëzakonshme kombëtare, rrethanat të tjera të emergjencave ekstreme, ose në raste të përdorimit për qëllime publike dhe jo tregtare në pajtim me Marrëveshjen e TRIPS.

#### **Neni 40**

#### **Kushtet për dhënien e licencës së detyrueshme për patentat e produkteve farmaceutike që synohen për eksport në vendet që kanë probleme me shëndetin publik**

1. Licenca e detyrueshme për patentat e produkteve farmaceutike që synohen për eksport në vendet që kanë probleme me shëndetin publik, jepet si licencë jo-ekskluzive, fusha dhe kohëzgjatja e së cilës përcaktohen me vendimin për dhënien e saj dhe do të jetë e kufizuar vetëm për qëllimin e përcaktuar me vendim. Sasia e produkteve që prodhohen sipas licencës së tillë nuk duhet të tejkalojë sasinë e nevojshme për të plotësuar nevojat e vendit importues, ose vendeve importuese të cekura në kërkesë, duke marrë parasysh sasinë e produkteve të prodhuara sipas licencës së detyrueshme të dhënë diku tjetër.

2. Licenca e detyrueshme bartet vetëm në punëtorinë e prodhimit gjegjësisht pjesët e saj, për të cilën është lejuar shpikja dhe e njëjta është shfrytëzuar.

3. Gjykata më vendim specifikon veprimet të cilat aplikuesi ka të drejtë t'i ndërmarr, dhe që janë të nevojshme me qëllim të prodhimit të produkteve të destinuara për eksport dhe shpërndarjen në vend apo vende të përmendura në kërkesë. Asnjë produkt i prodhuar ose i importuar në bazë të licencës së detyrueshme nuk do të ofrohet për shitje apo të plasohet në treg në asnjë vend tjetër i cili nuk është përmendur në kërkesë, me përjashtim kur një vend importues përfiton vetë nga mundësitë sipas vendimit të eksportit për anëtarët e tjerë sipas një marrëveshjeje të tregtisë rajonale që kanë probleme e njëjta të shëndetit publik.

4. Gjykata më vendim urdhëron që produktet me licencë të tillë të shënohen qartë, përmes Etiketimit ose shënimit specifik, të prodhuara me licencë të detyrueshme. Produktet e tilla duhet të dallohen nga të zakonshmet përmes paketimit, ngjyrës apo formës së veçantë, me kusht që shenjat që e dallojnë nuk kanë ndikim të madh në çmim. Në paketim dhe dokumentet shënohet se produkti është prodhuar sipas licencës së detyrueshme, duke i dhënë emrin e gjykatës kompetente, numrin e dosjes, specifikimin që produkti është i destinuar për eksport dhe shpërndarje në vendin ose vendet importuese. Detajet e karakteristikave të produktit duhet të jenë në dispozicion të autoriteteve doganore.

5. Gjykata më vendim urdhëron që para dërgimit të produktit në vendin importues, i licencuari t'ia komunikoj Zyrës adresën e web faqes ku i ka postuar të dhënat e mëposhtme:

5.1. sasi të e produkteve, me të cilat do të furnizohen vendet importuese sipas licencës;

5.2. tiparet dalluese të produktit në fjalë.

6. Nëse produkti i mbuluar nga licenca e detyrueshme e dhënë në Kosovë, është patentuar në shtetin importues të përmendur në kërkesë, produkti do të eksportohet vetëm në qoftë se ky vend ka lëshuar një licencë të detyrueshme për importimin, shitjen apo shpërndarjen e produktit.

7. Gjykata më vendim urdhëron aplikuesin për të paguar kompensimin për bartësin e të drejtës:

7.1. në situatat e jashtëzakonshme kombëtare, rrethanave të tjera të emergjencave ekstreme apo në raste të përdorimit publik jo-tregtar sipas Marrëveshjes TRIPS, kompensimi do të jetë në maksimum prej 4% të çmimit të përgjithshëm që duhet të paguhet nga vendi importues ose në emër të tij;

7.2. në të gjitha rastet e tjera, kompensimi - pagesa - përcaktohet duke marrë parasysh vlerën ekonomike të përdorimit të autorizuar në bazë të licencës për vendin importues ose të vendeve në fjalë, si dhe rrethanat humanitare apo jo-tregtare në lidhje me çështjen e licencës.

8. Kur vendimi i gjykatës për dhënien e licencës së detyrueshme është bërë përfundimtar, gjykata, me kërkesë për ruajtjen e provave të paraqitura nga mbajtësi i së drejtës, të kontrollojë dokumentacionin e të licencuarit, nëse janë përmbushur detyrimet e përcaktuara në vendimin për dhënien e licencës së detyrueshme, në veçanti ato që lidhen me destinacionin final të produkteve. Dokumentacioni duhet të përmbajë dëshmitë e eksportimit të produkteve, të vërtetuar nga autoritetet doganore, si dhe provën e importimit.

9. Kushtet e licencës nuk përcaktojnë metodën e shpërndarjes në vendin importues.

#### **Neni 41**

#### **Refuzimi i aplikacionit për dhënien e licencës së detyrueshme**

Gjykata me vendim refuzon kërkesën për dhënien e licencës së detyrueshme nëse nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara në këtë ligj.

#### **Neni 42**

#### **Përfundimi ose modifikimi i licencës së detyrueshme**



1. Bartësi i së drejtës ose i licencuari mund të inicioj procedurë në gjykatë, duke kërkuar nga gjykata që të ndërpresë vlefshmërinë e licencës së detyrueshme, nëse është konstatuar që pala e kundërt ka dështuar të respektoj vendimin për dhënien e licencës së përkohshme. Në vendimin e saj gjykata specifikon periudhën kohore në kuadër të së cilës, i licencuari do të aranzhoj që çdo produkt që posedon dhe e kontrollin, të ri-drejtohet me shpenzime të tija, në vendet që kanë nevojë, të cilat janë cekur në nenin 38 të këtij ligji, përndryshe të tërhiqet në konsultim me bartësi e të drejtës.

2. Kur vendi importues njofton se sasia e produktit farmaceutik është e pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e tija, i licencuari mund të iniciojnë procedurë në gjykatë për një kërkesë tjetër, duke pretenduar modifikimin e kushteve të licencës, me qëllim të lejimit të prodhimit dhe eksportimit të sasisë shtesë të produktit deri në masën e nevojshme për të plotësuar nevojat e vendit importues në fjalë. Në raste të tilla gjykata vepron në procedurë të shpejtë. Nëse sasia shtesë e produktit të kërkuara nuk kalon 25% të sasisë së përgjithshme, dispozitat e nenit 39 paragrafi 3. të këtij ligji nuk zbatohen.

#### **Neni 43 Njoftimet**

1. Gjykata njofton Këshillin e TRIPS përmes ndërmjetësuesit të Zyrës, më vendimin për dhënien e licencës së detyrueshme dhe kushtet e licencës, si dhe për ndërprerjen e vlefshmërisë ose modifikimin e saj.

2. Informatat e dhëna përfshinë në veçanti:

2.1. emrin dhe adresën e të licencuarit;

2.2. produktin në fjalë;

2.3. sasia që do të furnizohet;

2.4. vendin importues;

2.5. kohëzgjatjen e licencës;

2.6. adresën e ueb faqes të cekur në nenin 40, paragrafi 5. të këtij ligji.

#### **Neni 44 Ndalimi i importimit**

1. Ndalohet importimi në Republikën e Kosovës i produkteve të prodhuara në bazë të licencës së detyrueshme të lëshuar sipas këtij ligji, për qëllim të vënies në qarkullim të lirë të importit të sërishëm, vendosjes nën procedurat suspenzive apo vendosjes në zona të lira dhe magazina të lira.

2. Paragrafi 1. i këtij neni nuk zbatohet në rastin e eksportit të sërishëm të produktit në vendet importuese të cekura në kërkesë dhe të identifikuar në paketimin dhe dokumentacionin përcjellës të produktit, apo vendosjen në një procedurë magazinimi tranzitore apo doganore, tranzit, zonë të lirë ose magazinë doganore, me qëllim të eksportimit të sërishëm në vendin importues.

#### **Neni 45 Veprimet e autoriteteve doganore**

1. Nëse ka arsye të mjaftueshme për të dyshuar se produktet e prodhuara sipas licencës së detyrueshme të dhënë në përputhje me dispozitat e këtij ligji janë duke u importuar në Kosovë në kundërshtim me dispozitat e nenit 44 paragrafi 1. të këtij ligji, organet kompetente të doganës ndalojnë produktet në fjalë për t'i kontrolluar, por jo më shumë se dhjetë (10) ditë pune. Në rrethana të veçanta, autoritetet doganore vendosin për zgjatjen e periudhës së ndalimit në maksimum edhe prej dhjetë (10) ditë pune.

2. Autoriteti doganor informon menjëherë bartësin e së drejtës dhe prodhuesin ose eksportuesin e produkteve në fjalë, rreth ndalesave të cekura në paragrafin 1. të këtij neni dhe fton atë që të jap informacionet dhe prova për produktet në fjalë.

3. Në qoftë se në periudhën e ndalimit, autoritetet doganore vërtetojnë se ka shkelje të licencës së detyrueshme, në kundërshtim me ndalimin e cekur në nenin 44 paragrafi 1. të këtij ligji, konfiskon dhe largon produktet nga qarkullimi në përputhje me rregullat doganore.

4. Procedura e ndalimit dhe konfiskimit të mallrave bëhet me shpenzime të importuesit, në përputhje me rregullat doganore. Bashkë me importuesin lidhur me shpenzimet përgjigjet çdo person tjetër që tenton të bëjë importimin e paligjshëm.

5. Nëse konstatohet se importi i produkteve të ndaluara në përputhje me dispozitat e këtij neni nuk shkelin dispozitat e nenit 44 paragrafi 1. të këtij ligji, autoritetet doganore i lejojnë qarkullimin e produkteve në territorin e Republikës së Kosovës, me kusht që kjo është në pajtim me rregullat doganore.

6. Për çdo konfiskim dhe shkatërrim të produkteve, në përputhje me dispozitat e këtij neni Autoriteti doganor njofton Zyrën.

#### **Neni 46** **Importimi i sasisë së vogël**

Dispozitat e neneve 44 dhe 45 të këtij ligji nuk zbatohen për importin e sasive të vogla të produkteve brenda kufijve të caktuar sa i përket lirit nga detyrimet doganore, që gjenden në valixhet personale të udhëtarit të destinuara për përdorim personal dhe jo-tregtar.

### **KREU X** **PROCEDURA E DHËNIES SË PATENTËS**

#### **Neni 47** **Regjistrat**

1. Zyra mban Regjistrin e aplikimeve për patentë, Regjistrin e patentave, Regjistrin e certifikatave suplementare dhe Regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar.

2. Përmbajtja e regjistrave të cekura në paragrafin 1. të këtij neni, si dhe mënyra e mbajtjes së tyre përcaktohet me akt nënligjor.

3. Regjistrat nga paragrafi 1. i këtij neni janë publik.

#### **Neni 48** **Taksat**

1. Taksat për marrjen dhe mirëmbajtjen e patentës dhe certifikatës suplementare paguhen brenda afatit të caktuar me këtë ligj. Shuma dhe llojet e tarifave përcaktohen me akt nënligjor.

2. Në qoftë se taksat përkatëse nuk janë paguar para procedurës së dhënies së patentës, aplikimi për patentë do të konsiderohet i tërhequr, ndërsa në rast të mospagimit të tarifës për mbajtjen në fuqi të një patente, kjo e fundit do të skadojë.

#### **Neni 49** **Aplikimi për patentë**

1. Procedura për njohjen e së drejtës së patentës, fillon me dorëzimin e aplikacionit në Zyrë.

2. Mënyra e dorëzimit të aplikacionit për patentë përcaktohet me akt nënligjor.
3. Aplikacioni dorëzohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj ose një traktat ndërkombëtar detyrues për Kosovën.

#### **Neni 50** **Përmbajtja e aplikacionit**

1. Aplikacioni për patentë duhet të përmbaj:
  - 1.1. kërkesën për njohjen e patentës;
  - 1.2. përshkrimin e shpikjes;
  - 1.3. një ose më shumë kërkesa patentore;
  - 1.4. vizatimet të cilat i referohen përshkrimit të patentës dhe kërkesave patentore;
  - 1.5. abstraktin e shpikjes.
2. Aplikacioni përmban edhe:
  - 2.1. autorizimin për përfaqësim nga aplikuesi, nëse aplikacioni është dorëzuar nga një përfaqësues;
  - 2.2. përkthimin në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës i aplikacionit, nëse aplikacioni është dorëzuar në gjuhë të huaj, jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga data e dorëzimit e përcaktuar nga Zyra;
  - 2.3. dëshmi për pagesën e tarifës për aplikim.

#### **Neni 51** **Data e dorëzimit të aplikacionit**

1. Data e dorëzimit të aplikacionit për patentë, do të jetë data në të cilën aplikuesi ka paraqitur këto dokumente:
  - 1.1. cekja eksplicite me të cilën kërkohet njohja e së drejtës së patentës;
  - 1.2. informacionin që identifikon aplikuesin dhe mundëson kontaktimin me të;
  - 1.3. përshkrimin e shpikjes, edhe nëse përshkrimi i tillë nuk përputhet me të gjitha kërkesat e përcaktuara me këtë ligj dhe me akt nënligjor.
2. Aplikacioni për patentë për të cilën është përcaktuar data e dorëzimit do të regjistrohet në Regjistrin e aplikimeve për patentë që mbahet nga Zyra.

#### **Neni 52** **Certifikata e përparësisë**

1. Me kërkesën e aplikuesit, Zyra lëshon certifikatë për të drejtën e përparësisë, e cila është fituar në datën e dorëzimit të aplikimit për patentë të përcaktuar në pajtim me dispozitat e nenit 51 të këtij ligji.

2. Kushtet, procedura e lëshimit si dhe përmbajtja e certifikatës sipas paragrafit 1. të këtij neni përcaktohen me akt nënligjor.

### **Neni 53 Bashkimi i shpikjeve**

1. Për çdo shpikje paraqitet aplikacion i veçantë për patentë.
2. Me një aplikacion për patentë mund të kërkohet njohja e patentës edhe për më shumë shpikje vetëm në rastet kur ato shpikje janë të lidhur ndërmjet tyre ashtu që formojnë një koncept unik të shpikjes dhe me to realizohet uniteti i shpikjes.
3. Kur një grup shpikjesh është deklaruar në aplikacionin për patentë, kërkesa e bashkimit realizohet vetëm kur ekziston një lidhje teknike midis atyre shpikjeve, që përfshinë një apo më shumë tipare teknike të njëjta ose korresponduese të tipareve speciale. Shprehja "tipare të veçanta teknike" nënkupton ato tipare që përcaktojnë kontributin i cili prej shpikjeve të deklaruara i merr si tërësi dhe tejkalon njohuritë e mëparshme.
4. Përcaktimi nëse një grup i shpikjeve është e lidhur në mënyrë që të formojnë një koncept të vetëm të përgjithshëm shpikës, bëhet pa marrë parasysh nëse shpikjet janë deklaruar në kërkesa të ndara ose si alternativa brenda një kërkesë të vetme.

### **Neni 54 Kërkesa për njohjen e patentës**

1. Kërkesa për njohjen e patentës dorëzohet në një formular të përpiluar nga Zyra dhe duhet të përmbajë:
  - 1.1. kërkesën për njohjen e patentës;
  - 1.2. titullin e shpikjes, i cili paraqet në mënyrë të qartë emërtimin teknik të shpikjes si dhe të dhënat e paraqitësit të aplikacionit dhe shpikësit.
2. Në rast se shpikësi nuk dëshiron të përmendet në aplikacion, deklaron me shkrim se ai nuk do që të përmendet në aplikacion si shpikës, e cila deklaratë duhet t'i dorëzohet Zyrës jo më vonë se dy (2) muaj nga data paraqitjes së aplikacionit.
3. Përmbajtja dhe mënyra e hartimit të elementeve të veçanta të aplikacionit për patentë dhe dokumentet tjera shtesë përcaktohen me akt nënligjor.

### **Neni 55 Shpalosja e shpikjes**

1. Aplikacioni për patentë duhet të shpalos shpikjen në mënyrë të qartë dhe të plotë, në mënyrë që ajo të mund të realizohet nga personi që ka njohuri nga ajo fushë.
2. Nëse një shpikje përfshin përdorimin apo ka të bëjë me materialin biologjik që nuk është në dispozicion të publikut dhe i cili nuk mund të përshkruhet në aplikacionin për patentë në mënyrë të tillë që të mundësojë që shpikja të realizohet nga personi me njohuri në atë fushë, aplikacioni duhet të shoqërohet me prova për efektin se mostra e materialit të tillë ka qenë e depozituar në institucionin kompetent jo më vonë se në datën e dorëzimit të aplikacionit për patentë.

3. Si institucion kompetent i cekur në paragrafin 2. të këtij neni konsiderohet një institucion që është në përputhje me kushtet e përshkruara nga Traktati i Budapestit.

#### **Neni 56** **Kërkesat patentore**

1. Kërkesat patentore përcaktojnë objektin për të cilin kërkohet mbrojtja. Ato duhet të jenë të qarta, të përmbledhura, dhe të mbështetura në përshkrimin e shpikjes.

2. Kërkesat patentore mund të jenë të pavarura dhe të varura. Kërkesat patentore të pavarura përmbajnë karakteristikat e reja dhe thelbësore të shpikjes. Kërkesat patentore të varura përmbajnë karakteristikat specifike të shpikjes siç është përcaktuar në kërkesën patentore tjetër të varur ose të pavarur.

#### **Neni 57** **Abstrakti**

Abstrakti shërben vetëm për qëllime të informatave teknike dhe nuk merret parasysh për qëllime tjera, në veçanti për të dëshmuar fushën e mbrojtjes së kërkuar apo në zbatim të nenit 11, paragrafi 3. i këtij ligji.

#### **Neni 58** **Ndarja e aplikacionit për patentë**

1. Me kërkesë të aplikuesit ose me kërkesën e Zyrës mund të ndahet lënda e aplikimit për patentim të cilit i është aprovuar data e dorëzimit të aplikacionit bazë në dy ose më shumë aplikacione të ndara dhe për secilin vazhdohet procedura e pavarur.

2. Lënda e mbrojtjes së aplikimit të ndarë për patentë, nuk lejohet të del jashtë përmbajtjes së aplikimit bazë.

3. Ndarja e aplikimit bazë për patentë është e lejuar deri në marrjen e vendimit mbi kërkesën për dhënien e patentës.

4. Çdo aplikim i ndarë ka të drejtë të fitojë datën e dorëzimit të aplikimit bazë, nëse është në pajtim nënin 63 të këtij ligji.

#### **Neni 59** **Ndryshimet në aplikimin për patentë**

Aplikacioni për patentë të cilit i është caktuar data e dorëzimit, nuk mund të zgjerohet fusha e mbrojtjes për të cilën është aplikuar.

#### **Neni 60** **Regjistrimi i ndryshimeve në regjistra**

1. Me kërkesë të palës për regjistrim të ndryshimeve në regjistër, Zyra lëshon vendim për regjistrimin në regjistrat të cekur në nenin 47 të këtij ligji, për ndryshimet lidhur me të drejtën ose pronarin e të drejtës, të cilat kanë ndodhur pas datës së dorëzimit të aplikacionit ose sipas regjistrimit të vendimit për dhënie të patentës.

2. Ndryshimet e regjistruara të cekura në paragrafin 1. të këtij neni publikohen në Buletinin Zyrtar të Zyrës.

3. Procedura lidhur me regjistrimin e ndryshimeve dhe publikimin e ndryshimeve në Buletinin Zyrtar si dhe lartësia e tarifave do të përcaktohet me akt nënligjor

#### **Neni 61** **Përmirësimi i gabimeve në dokumente**

1. Gabimet formale në dokumentet e dorëzuara në Zyrë, përmirësohen me kërkesë me shkrim të paraqitur nga aplikuesi i patentës, gjegjësisht pronari i patentës si dhe me anë të njoftimit nga Zyra, kundrejt një tarife sipas nenit 48 të këtij ligji.

2. Në vendimet e Zyrës, mund të përmirësohen vetëm gabimet gjuhësore dhe teknike.

#### **Neni 62** **Përparësia e aplikimit të mëhershëm**

1. Nëse të njëjtën shpikje e kanë bërë dy ose më shumë shpikës pavarësisht nga njëri tjetri, përparësi në njohjen e së drejtës së patentës ka aplikuesi, aplikacioni i të cilit ka datë të mëhershme të dorëzimit.

2. Përparësia vlen prej datës së dorëzimit të aplikacionit në Zyrë, përveç në rastet kur janë plotësuar kushtet për dhënien e përparësisë sipas nenit 63 të këtij ligji.

#### **Neni 63** **E drejta e përparësisë**

1. Çdo person fizik ose juridik, ose trashëgimtari i tij ligjor, i cili në ndonjë shtet anëtar që është palë e Konventës së Parisit, ose OBT-së, ka dorëzuar aplikacion të rregullt për patentë njihet në Kosovë e drejta e përparësisë në afatin prej dymbëdhjetë (12) muajve prej datës së dorëzimit të aplikacionit të parë, me kusht që të ketë kërkuar njohjen e së drejtës së përparësisë me qëllim të dorëzimit të aplikacionit në Kosovë për të njëjtën shpikje.

2. Dorëzim i rregullt i aplikacionit të cekur në paragrafin 1. të këtij neni konsiderohet aplikacioni, data e dorëzimit, e të cilit është aprovuar në pajtim me ligjet kombëtare të shteteve anëtarë të Unionit të Parisit ose anëtarë të OBT-së, në të cilin është dorëzuar aplikimi ose në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura ndërmjet shteteve anëtarë, çfarëdo që të jetë rezultati i aplikacionit.

3. Aplikacioni i mëvonshëm për patentë që është dorëzuar në të njëjtin ose për të njëjtin shtet, konsiderohet si aplikim i parë, për nevoja të përcaktimit të së drejtës së përparësisë, në pjesën që ka të bëjë me lëndën e shpikjes së aplikacionit të parë, nëse në datën e dorëzimit të aplikacionit të mëvonshëm, aplikacioni i parë që ka shërbyer për përcaktimin e të drejtës së përparësisë, është tërhequr, refuzuar ose hedhur poshtë para se të jetë bërë e njohur për publikun dhe nuk ka prodhuar efekte juridike. Aplikimi i parë për patentë nuk mund të shërbejë më si bazë për kërkesë të së drejtës së përparësisë.

4. Aplikuesi për patentim, i cili ka për qëllim ta shfrytëzojë të drejtën e përparësisë nga paragrafi 1. i këtij neni në Kosovë, duhet që në Zyrë të dorëzojë:

4.1. kërkesën për njohjen e të drejtës së përparësisë që përmban të dhënat kryesore për aplikimin e parë, përparësia e të cilit kërkohet, numrin dhe datën e dorëzimit të aplikacionit, shtetit anëtar të Unionit të Parisit ose anëtar të OBT-së në të cilin është dorëzuar aplikacioni ose për të cilin është dorëzuar, më së voni deri dy (2) muaj nga data e dorëzimit të aplikacionit në Kosovë, dhe

4.2. kopjen e aplikacionit të parë e vërtetuar nga organi kompetent i shtetit anëtar të Unionit të Parisit ose anëtar të OBT-së, në të cilin ose për të cilin është dorëzuar aplikacioni, më së voni deri në mbarimin e afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh prej datës së dorëzimit të kërkesës për dhënien e të drejtës së përparësisë, ose katër (4) muaj nga data e dorëzimit të aplikacionit në Kosovë, apo gjashtëmbëdhjetë (16) muaj nga data më e hershme e kërkesave të së drejtës së përparësisë, varësisht nga ajo se cila prej afateve të cekura skadon më herët.

#### **Neni 64**

#### **Kërkesa për të drejtën e shumëfishtë të përparësisë**

1. Aplikuesi për patentë mundet, sipas kushteve nga neni 63 i këtij ligji, të kërkojë dhënien e të drejtës së shumëfishtë të përparësisë në bazë të disa aplikimeve të dorëzuara më herët në një ose më shumë shtete anëtarë të Unionit të Parisit ose anëtarë të OBT-së.
2. Nëse është kërkuar e drejta e shumëfishtë e përparësisë, afati kohor i cili sipas këtij ligji fillon nga data e dhënies së përparësisë do të llogaritet prej datës më të hershme të përparësisë së shumëfishtë.

#### **Neni 65**

#### **Elementet e shpikjes që kanë të bëjnë me kërkesën patentore për të drejtën e përparësisë**

1. Nëse kërkohet njohja e një apo të disa të drejtave të përparësisë është vetëm për ato elemente të shpikjes të cilat janë të cekura në aplikacionin e parë apo në disa aplikacione, përparësia e së cilës është kërkuar.
2. Nëse elementet e caktuara të shpikjes për të cilat kërkohet përparësia nuk paraqiten në kuadër të kërkesave patentore në aplikacionin e parë, e drejta e përparësisë do të njihet, me kusht që elementet e aplikacionit të parë mund të vërtetohen nga të gjitha pjesët përbërëse të aplikacionit.

#### **Neni 66**

#### **Ndikimi i të drejtës së përparësisë**

Data e njohjes së drejtës së përparësisë konsiderohet data e dorëzimit të aplikimit për patentë në Zyrë, sipas nenit 11 paragrafët 2. dhe 3. dhe nenit 62 paragrafi 1. të këtij ligji.

#### **Neni 67**

#### **Rivendosja e së drejtës së përparësisë**

1. Nëse aplikacioni për patentë me të cilin është kërkuar e drejta e përparësisë nga aplikacioni i parë i paraqitur në datën i cili është i mëvonshëm se data në të cilën kalon periudha e përparësisë në bazë të nenit 63 paragrafi 1. të këtij ligji, paraqitësi i aplikacionit të patentës mund të paraqes kërkesë për rivendosjen e së drejtës së përparësisë.
2. Kërkesa e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni dorëzohet brenda dy (2) muajve nga data e skadimit të periudhës së të drejtës për përparësi.
3. Zyra miraton kërkesën për rivendosjen e të drejtës së përparësisë, me kusht që aplikuesi:
  - 3.1. të cekë arsyet të cilat vërtetojnë se deri te lëshimi i afatit me të cilin pranohet periudha e përparësisë ka ardhur edhe përkundër kujdesit të duhur; dhe
  - 3.2. të paguaj tarifat e përcaktuar me nenin 48 të këtij ligji.
4. Nëse aplikuesi nuk i plotëson kushtet nga paragrafi 3. i këtij neni, Zyra me vendim refuzon kërkesën për rivendosjen e së drejtës së përparësisë.

5. Kërkesa e cekur në paragrafin 1. të këtij neni nuk mund të paraqitet pasi që aplikuesi ka dorëzuar kërkesën për publikimin e aplikimit sipas nenit 75 paragrafit 2. të këtij ligji, përveç nëse kërkesa e tillë për publikim, është tërhequr para se të kenë përfunduar përgatitjet teknike për publikimin e aplikimit.

#### **Neni 68**

#### **Korrigjimi ose plotësimi i kërkesës të së drejtës së përparësisë**

1. Aplikuesi për patentë, mund të paraqes kërkesën për korrigjimin ose plotësimin e kërkesës për njohjen e së drejtës së përparësisë, brenda afatit kohor prej gjashtëmbëdhjetë (16) muajve nga data e së drejtës për përparësi, apo nëse korrigjimi ose plotësimi do të shkaktoj ndryshime në datën e përparësisë, gjashtëmbëdhjetë (16) muaj nga data e kërkuar për korrigjim apo plotësim të përparësisë, nga periudha e mëhershme gjashtëmbëdhjetë (16) mujore, me kusht që kërkesa e tillë të jetë paraqitur brenda katër (4) muajve nga data e paraqitjes së aplikacionit për patentë.

2. Për korrigjimin apo plotësimin e kërkesës sipas paragrafit 1. të këtij neni aplikuesi paguan tarifën përkatëse. Në rast të mospagimit të tarifës kërkesa konsiderohet se nuk është bërë.

3. Nëse data e përparësisë është ndryshuar për shkak të korrigjimit ose plotësimit të kërkesës, afati kohor duhet të llogaritet nga data e përparësisë së ndryshuar.

4. Kërkesa sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk mund të paraqitet pasi që aplikuesi ka dorëzuar kërkesën për publikimin e aplikimit sipas nenit 75 paragrafit 2. të këtij ligji, përveç nëse kërkesa e tillë për publikim, është tërhequr para se të kenë përfunduar përgatitjet teknike për publikimin e aplikimit.

#### **Neni 69**

#### **Përcaktimi i datës së dorëzimit të aplikacionit**

1. Zyra me rastin e përcaktimit të datës së dorëzimit të aplikacionit, kontrollon nëse janë përmbushur kërkesat sipas nenit 51 të këtij ligji.

2. Nëse aplikacioni nuk përmban të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 51 të këtij ligji dhe nuk mund t'i caktohet data e dorëzimit, zyra do të ftoj aplikuesin, që të korrigjoj mungesat e cekura në ftesë, në një afat kohor prej dy (2) muajve nga data e pranimit të njoftimit.

3. Nëse aplikuesi nuk i përgjigjet ftesës së zyrës, brenda afatit kohor sipas paragrafit 2. të këtij neni, aplikacioni për patentë refuzohet me vendim.

4. Nëse aplikuesi korrigjon mangësitë në afatin kohor të cekur në paragrafin 2. të këtij neni, zyra nxjerr një njoftim me ç'rast data e pranimit të korrigjimeve përcaktohet si data e dorëzimit të aplikacionit për patentë dhe regjistron aplikimin në regjistrin e aplikimeve për patentë, i cili mbahet nga Zyra.

#### **Neni 70**

#### **Ekzaminimi formal i aplikacionit**

1. Pas përcaktimit të datës së dorëzimit të aplikacionit, Zyra do të ekzaminoj:

1.1. nëse taksa administrative për dorëzim, është paguar sipas nenit 48 të këtij ligji;

1.2. nëse është dorëzuar përkthimi i aplikimit në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, kur aplikimi është dorëzuar në gjuhë të huaj;



1.3. nëse përfaqësimi për personat juridik dhe fizik të huaj bëhet përmes përfaqësuesve të autorizuar të regjistruar në Regjistër;

1.4. nëse i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me nenin 50 të këtij ligji që janë përpiluar në mënyrën e parashikuar dhe bashkëngjitet e nevojshme të parapara me këtë ligj;

1.5. nëse përmendet shpikësi;

1.6. nëse është dorëzuar kërkesa e përparësisë sipas nenit 63 paragrafi 4. të këtij ligji, kur kërkohet e drejta e përparësisë;

2. Nëse me ekzaminim vërtetohet se nuk janë përmbushur kërkesat sipas paragrafit 1. të këtij neni, Zyra fton aplikuesin që të korrigjoj mangësitë që janë cekur në ftesë, brenda afatit kohor prej dy (2) muajve nga data e pranimi të njoftimit.

3. Me kërkesë të aplikuesit, Zyra mund të zgjas afatin kohor të cekur në paragrafin 2. të këtij neni, për një periudhë që e konsideron si të arsyeshme, por jo më shumë se tre (3) muaj.

4. Nëse aplikuesi nuk i përmirëson mangësitë e cekura në paragrafin 1. nën-paragrafi 1.1., 1.2., 1.3., 1.4., 1.5. të këtij neni, brenda afatit të caktuar kohor, Zyra nxjerr vendimin për refuzimin e aplikacionit për patentë.

5. Nëse aplikuesi nuk i përgjigjet ftesës së cekur në paragrafin 1. nën-paragrafi 1.6 të këtij neni, atëherë Zyra nuk ia njeh të drejtën e përparësisë.

6. Zyra ka të drejtë t'i kërkojë aplikuesit depozitimin e dokumenteve shtesë të nevojshme për ekzaminimin e aplikimit, nëpërmjet një njoftimi me shkrim si dhe të caktojë afatin për depozitimin e tyre kur e çmon të nevojshme.

7. Në përputhje me paragrafin 6. të këtij neni, Zyra merr vendim për njohjen ose jo të patentës.

#### **Neni 71**

##### **Ekzaminimi i vizatimeve apo i pjesëve që mungojnë nga përshkrimi**

1. Nëse gjatë ekzaminimit Zyra vërteton se mungon një pjesë e përshkrimit apo e vizatimit nga aplikacioni, Zyra njofton menjëherë aplikuesin që të plotësoj aplikacionin me pjesët e përshkrimit apo vizatimet që mungojnë, brenda dy (2) muajve nga pranimi i ftesës.

2. Nëse pjesa që mungon e përshkrimit ose vizatimet, dorëzohet në Zyrë brenda afatit kohor të caktuar në paragrafin 1. të këtij neni, ajo pjesë e përshkrimit ose ai vizatim përfshihet në aplikacion dhe data e dorëzimit do të jetë data në të cilën Zyra ka pranuar pjesën e përshkrimit ose vizatimit. Në të kundërtën konsiderohet se aplikuesi nuk u referohet pjesëve të përshkrimit apo vizatimeve.

#### **Neni 72**

##### **Ekzaminimi i kërkesës për regjistrimin e patentës**

1. Ekzaminimi i kërkesave për regjistrimin e patentës, përcakton nëse aplikacioni është në pajtim me kushtet në vijim:

1.1. nëse lënda e aplikimit është shpikje, që në shikimin e parë mund të duket si e tillë e që mbrohet me patentë sipas nenit 7 paragrafi 1. dhe 3., neni 8, 9, 10 dhe 14 të këtij ligji;

1.2. nëse aplikimi në shikim të parë është në pajtim me rregullën e bashkimit të shpikjeve të përcaktuar në nenin 53 të këtij ligji.

#### **Neni 73**

## **Refuzimi i aplikacionit**

1. Nëse është përcaktuar se aplikacioni për patentë nuk i përmbush të gjitha kushtet për regjistrimin e patentës sipas nenit 72 paragrafi 1. të këtij ligji, Zyra njofton aplikuesin me shkrim për arsyet për të cilat patentat nuk do njihet dhe e fton atë që të komentoj me shkrim për arsyet specifike brenda afatit kohor prej dy (2) muajve që nga dita e marrjes së ftesës.
2. Me kërkesë të aplikuesit Zyra mund të zgjas afatin kohor edhe për dy (2) muaj, sipas paragrafit 1. të këtij neni.
3. Zyra nxjerr vendim për refuzimin e aplikacionit për patentë, nëse aplikuesi për patentë nuk i përgjigjet njoftimit sipas paragrafit 1. të këtij neni.
4. Nëse nuk përmbushen kërkesat sipas nenit 72 paragrafi 1. të këtij ligji në një pjesë, Zyra me vendim refuzon aplikacionin vetëm për atë pjesë.

### **Neni 74**

#### **Njohja e së drejtës së patentës**

1. Nëse është përcaktuar që aplikacioni për patentë përmbush të gjitha kërkesat sipas nenit 70 dhe nenit 72 paragrafi 1. i këtij ligji, Zyra nxjerr vendimin për njohjen e së drejtës së patentës dhe e regjistron patentën në Regjistrin e patentave.
2. Zyra nxjerr vendimin sipas paragrafit 1. të këtij neni pas skadimit të afatit prej tetëmbëdhjetë (18) muajve nga data e dorëzimit të aplikacionit, ose nëse kërkohet përparësia, nga data me e hershme përparësisë me kusht që tarifat për mirëmbajtjen e patentës, vendimit, publikimit, certifikatës dhe specifikacionit të jenë paguar sipas nenit 48 të këtij ligji, nga aplikuesi apo brenda dy (2) muajve nga marrja e njoftimit të Zyrës.
3. Patentat e njohur prodhon efekte juridike ndaj palëve të treta nga data e publikimit në Buletinin Zyrtar.
4. Deri sa të nxirret vendimi sipas nenit 79 paragrafi 2. të këtij ligji fusha e mbrojtjes përcaktohet sipas përmbajtjes së kërkesave patentore, ashtu siç janë aplikuar.

### **Neni 75**

#### **Publikimi i patentës së regjistruar**

1. Zyra publikon patentën pas vendimit për njohjen e të drejtës së patentës sipas nenit 74 paragrafit 1. të këtij ligji.
2. Aplikuesi mund të kërkojë që vendimi për njohjen e të drejtës së patentës të lëshohet dhe të publikohet edhe para skadimit të afatit kohor sipas nenit 74 paragrafi 2. të këtij ligji, por jo para nëntëdhjetë (90) ditëve nga data e dorëzimit, ose nëse është kërkuar përparësia, nga data e më hershme e përparësisë, me kusht që të jenë paguar tarifat shtesë sipas nenit 48 të këtij ligji.
3. Përmbajtja e publikimit të patentës së regjistruar përcaktohet me akt nënligjor.

### **Neni 76**

#### **Certifikata e patentës**

1. Pronarit të patentës i lëshohet certifikata e patentës pas datës së lëshimit të vendimit.
2. Përmbajtja dhe forma e certifikatës sipas paragrafit 1. të këtij neni përcaktohet me akt nënligjor.

### **Neni 77**

#### **Specifikacioni i patentës**

1. Pronarit të patentës i lëshohet specifikacioni për patentë pas datës së lëshimit të vendimit,
2. Përmbajtja dhe forma e specifikacionit për patentë sipas paragrafit 1. të këtij neni përcaktohet me akt nënligjor.

### **Neni 78**

#### **Dorëzimi i dëshmisë për patentën e regjistruar pranë zyrave përkatëse**

1. Pronari i patentës i dorëzon Zyrës dëshmi me shkrim që shpikja e patentuar është në pajtim me të gjitha kërkesat e cekura në nenet 7, 8, 9,10,11,12 dhe14 të këtij ligji, më së voni pas skadimit të vitit të nëntë të afatit të patentës.
2. Pronari i patentës paguan taksën për lëshimin e vendimit, sipas nenit 48 të këtij ligji, kur e dorëzon dëshminë sipas paragrafit 1. të këtij neni, ose brenda dy (2) muajve (nga pranimi i njoftimit prej Zyrës.
3. Dëshmia me shkrim sipas paragrafit 1. të këtij neni, e patentës së dhënë për të njëjtën shpikje nga Zyra Evropiane e Patentave, ose nga njëra prej zyrave kombëtare që në bazë të Traktatit të Bashkëpunimit për Patenta, ka statusin e Autoritet Paraparak Ndërkombëtar Ekzaminues për aplikimet për patenta ndërkombëtare, dhe zyrat e tjera me të cilat Zyra ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në kohën e dorëzimit të dëshmisë sipas paragrafit 1. të këtij neni, dëshmia duhet të jetë e përkthyer në gjuhët zyrtare.
4. Nëse procedura e njohjes së patentës në njërën nga zyrat përkatëse nuk është përfunduar ende, aplikuesi njofton Zyrën në përputhje me afatin kohor, të paraparë sipas paragrafit 1. të këtij neni dhe Zyra mund të zgjas afatin kohor më së shumti deri në nëntëdhjetë (90) ditë pas përfundimit të procedurës së ekzaminimit substancial në zyrën përkatëse. Nëse dëshmia nuk dorëzohet në afatin e caktuar zbatohen dispozita e paragrafit 1. të nenit 80 të këtij ligji.

### **Neni 79**

#### **Vendimet pas dorëzimit të dëshmisë**

1. Nëse pronari i patentës nuk e dorëzon dëshminë sipas paragrafi 1. të nenit 78 të këtij ligji, patenta përfundon në datën e përfundimit të vitit të dhjetë të patentës.
2. Nëse në bazë të dëshmisë së dorëzuar Zyra gjen se shpikja:
  - 2.1. përmbush tërësisht kërkesat për patentueshmërisë sipas nenit 78 paragrafi 1. i këtij ligji, Zyra nxjerr vendim ku deklaron se shpikja e patentuar përmbush kërkesat për patentueshmëri;
  - 2.2. përmbush vetëm pjesërisht kushtet për patentueshmëri sipas nenit 78 të paragrafit 1. të këtij ligji, Zyra nxjerr vendim ku deklaron që shpikja e patentuar i përmbushë kërkesat për patentueshmëri vetëm pjesërisht dhe ndryshon kërkesën për njohjen e patentës përkatësisht ri - lëshon specifikacionin për patentë pas pagesës së taksës sipas nenit 48 të këtij ligji.
3. Nëse Zyra vlerëson se shpikja nuk përmbushë kushtet për patentueshmëri sipas nenit 78, paragrafi 1. i këtij ligji, nxjerrë vendim duke deklaruar që patenta dhe aplikacioni për patentë nuk kanë pasur efekt.
4. Zyra njofton pronarin e patentës për vendimet sipas paragrafëve 2. dhe 3. të këtij neni dhe e njofton atë që të dorëzoj një koment të shkruar brenda dy (2) muajve nga dita e pranimit të njoftimit.
5. Nëse pronari i patentës nuk i përgjigjët njoftimit brenda afatit kohor sipas paragrafit 4. të këtij neni, Zyra nxjerr vendim ku deklaron se patenta dhe aplikacioni nuk kanë pasur efektet.

6. Në bazë të dëshmisë së dorëzuar me shkrim, aty ky Zyra konsideron që patenta e dhënë nuk përmbush kërkesat sipas nenit 53 të këtij ligji pronari i patentës do të ndaj patentën në një ose më shumë patenta, duke ruajtur datën e dorëzimit të aplikacionit fillestar ose datën e përparësisë nëse është kërkuar e drejta për përparësi, me kusht që janë paguar tarifat e përcaktuara.

7. Shkresa relevante nga vendimi i cekur në këtë nen, publikohet në Buletinin Zyrtar, siç është përcaktuar me akt nënligjor.

### **Neni 80** **Rivendosja e sërishme e të drejtave**

1. Nëse aplikuesi ose pronari i patentës nuk ka vepruar brenda afatit kohor, të përcaktuar me këtë ligj ose akt nënligjor, në lidhje me përmbushjen e obligimeve në afat ndaj Zyrës, rezultat i së cilës është humbja e të drejtës së fituar përmes aplikacionit për patentë ose patentës, mund të paraqes kërkesë për rivendosjen e së drejtës për njohjen së patentës.

2. Zyra aprovon kërkesën për rivendosjen e së drejtës për njohjen e patentës me vendim, me kusht që aplikuesi:

2.1. të paraqet kërkesën për rivendosje e të drejtës dhe të paguaj tarifën sipas nenit 49 të këtij ligji;

2.2. të tregojë bazat në të cilën bazohet kërkesa dhe vendos faktet në të cilat mbështet ajo;

2.3. kompletton veprimet e lëna jashtë brenda afatit të caktuar kohor.

3. Kërkesa për rivendosjen e të drejtave mund të dorëzohet brenda tre (3) muajve, duke llogaritur prej datës kur pushon së ekzistuari arsyeja e mos përmbushjes, dhe nëse aplikuesi është vënë në dijeni për këtë mos përmbushje në afat të mëvonshëm, llogaritja bëhet prej ditës kur ka marrë dijeni për këtë.

4. Kërkesa sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk dorëzohet pas skadimit të një (1) viti nga data e dështimit për të përmbushur afatit kohor.

5. Para vendimit të refuzimit të plotë ose të pjesërishtëm, Zyra duhet të njoftoj paraqitësin e kërkesës për rivendosjen e të drejtave për arsyet për të cilat do të refuzoj kërkesën tërësisht ose pjesërisht, dhe e njofton paraqitësin të deklarohet lidhur me njoftimin në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

6. Kërkesa për rivendosjen e të drejtave nuk mund të dorëzohet në rast të mos përmbushjes së veprimeve të mëposhtme:

6.1. paraqitjen e kërkesës nga paragrafi 1. i këtij neni;

6.2. paraqitjen e kërkesës për vazhdimin e afatit;

6.3. pagesën e tarifës administrative dhe pagesën e tarifës për mirëmbajtjen e patentës,

6.4. paraqitjen e kërkesës të referuar në nenet 63, 67 dhe 68 të këtij ligji;

6.5. paraqitjen e kërkesës të referuara në nenin 81 të këtij ligji;

6.6. të gjitha aktet në procedurat para Zyrës, që përfshijnë disa palë.

7. Përmbajtja e kërkesës, kushtet dhe procedura lidhur me kërkesën sipas paragrafit 1. të këtij neni, dhe publikimin e të dhënave lidhur me rivendosjen e drejtë përcaktohet me akt nënligjor.

8. Çdo person që me mirëbesim ka përdorur ose ka bërë përgatitje efektive e serioze për përdorimin e një shpikjeje e cila është subjekt i një patente të dhënë në periudhën ndërmjet humbjes e të drejtave sipas paragrafit 1. të këtij neni dhe publikimit në Buletinin Zyrtar të rivendosjes së këtyre të drejtave të përmendura, mund të vazhdojë pa kompensim të dëmeve përdorimin e tillë në rrjedhën e biznesit të tij ose për nevojat e tyre.

### **Neni 81 Vazhdimi i procedurës**

1. Nëse aplikuesi ose pronari i një patente nuk ka përbushur obligimet para Zyrës në afatin kohor dhe dështimi është pasojë e drejtpërdrejtë që shkakton humbje të të drejtave të dhëna nga kërkesa për patentë ose nga patenta, ai mund të paraqesë një kërkesë për vazhdimin e procedurës në lidhje me aplikimin për patentë ose patentën.

2. Zyra aprovon kërkesën për vazhdimin e procedurës, me kusht që aplikuesi:

2.1. të paraqes kërkesë për vazhdimin e procedurës dhe përbush të gjitha veprimet e pa kryera brenda afatit të caktuar; dhe

2.2. paguan tarifën sipas nenit 48 të këtij ligji.

3. Kërkesa për vazhdimin e procedurës mund të dorëzohet dy (2) muajve nga data në të cilën personi u njoftua me pasojat juridike të referuara në paragrafin 1. të këtij neni.

4. Në qoftë se nuk janë kryer obligimet brenda afatit të referuar në paragrafin 3. të këtij neni, apo nuk janë paguar tarifatat sipas nenit 48 të këtij ligji, konsiderohet se kërkesa për vazhdimin e procedurës nuk është paraqitur si dorëzues dhe për këtë lëshohet vendim nga Zyra.

5. Kërkesa për vazhdimin e procedurës nuk do të pranohet, nëse aplikuesi nuk ka përbushur obligimet e mëposhtme:

5.1. paraqitjen e kërkesës nga paragrafi 1. i këtij neni;

5.2. paraqitjen e kërkesës për vazhdimin e afatit;

5.3. pagesën e tarifës administrative dhe pagesën e tarifës për mirëmbajtjen e patentës,

5.4. paraqitjen e kërkesës të referuar në nenet 63, 67 dhe 68 të këtij ligji;

5.5. paraqitjen e kërkesës të cekur në nenin 81 të këtij ligji;

5.6. të gjitha aktet në procedurat para Zyrës, që përfshijnë disa palë.

6. Nëse Zyra aprovon kërkesën e cekur në paragrafin 1. të këtij neni, do të zbatohen dispozitat e përcaktuara në nenin 80 paragrafi 7. të këtij ligji.

## **KREU XI KOHËZGJATJA, MIRËMBAJTJA DHE NDËRPRERJA E SË DREJTËS SË PATENTËS**

### **Neni 82 Kohëzgjatja e mbrojtjes**

Afati i patentës është njëzet (20) vite nga data e dorëzimit të aplikacionit.

### **Neni 83**

## **Mirëmbajtja dhe ndërprerja e patentës**

1. Mirëmbajtja e të drejtave të dhëna nga patenta do t'i nënshtrohet pagesës së tarifave vjetore në mënyrë të përcaktuar me akt nënligjor.
2. Tarifa vjetore e cekur në paragrafin 1. të këtij neni paguhet prej vitit të tretë dhe çdo vit vijues, e llogaritet nga data e paraqitjes së aplikacionit.
3. Nëse pronari i patentës nuk paguan tarifat e cekura ne paragrafin 1. të këtij neni, ai mund të paguaj ato në afatin shtesë prej gjashtë (6) muajsh, me kusht që ai të paguan tarifën shtesë.
4. Nëse pronari i patentës nuk paguan tarifën e paraparë për mirëmbajtje të patentës, vlefshmëria e patentës përfundon ditën e parë pas skadimit të afatit të paraparë për pagesë të cekur në paragrafin 1. të këtij neni.
5. Tarifat për mirëmbajtjen e patentës mund te paguhet nga çdo përfaqësues i regjistruar ne Regjistrin e Zyrës.

## **KREU XII CERTIFIKATA SUPLEMENTARE PËR MBORJTJEN E PRODUKTEVE FARMACEUTIKE DHE PRODUKTEVE BIMORE**

### **Neni 84 Kuptimi i shprehjeve**

1. Shprehjet e përdorura në lidhje me certifikatat suplementare kanë këto kuptime:

1.1. produkt mjekësor - çdo substancë apo kombinim të substancave të destinuara për trajtimin apo parandalimin e sëmundjeve tek qeniet njerëzore, shtazët, dhe çdo substancë apo kombinim i substancave, të cilat mund t'u jepen qenieve njerëzore apo kafshëve me qëllim të rivendosjes, korrigjimit ose modifikimit të funksionit fiziologjik të tyre, ose për të bërë një diagnozë mjekësore;

1.2. produkt - substanca aktive ose kombinimin e përbërësve aktivë të një produkti mjekësorë;

1.3. patenta bazë - patenta e caktuar nga pronari i saj për ndjekjen e procedurës për dhënien e certifikatës Suplementare, për të mbrojtur produktin si të tillë, siç përcaktohet në nën-paragrafin 1.2 të këtij paragrafi, apo procesin për të përfituar një produkt apo aplikimin e një produktit;

1.4. autorizimi i parë për vendosje në treg - autorizimi i parë për të vendosur në treg një produkt si produkt mjekësor i destinuar për njerëzit apo kafshët në Republikën e Kosovës apo në Bashkimin Evropian;

1.5. aplikimi për zgjatje të afatit - aplikimi për zgjatje të afatit të certifikatës sipas nenit 13 (3) dhe nenit 36 të Rregullores (EC) Nr 1901/2006 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 12 dhjetor 2006 për produktet mjekësore për përdorim në pediatri.

2. Termat e përdorur për certifikata suplementare të dhëna për produktet për mbrojtjen e bimëve - në tekstin e mëtejme certifikata - kanë këto kuptime:

2.1. produkt për mbrojtjen e bimëve - nënkupton substancën aktive ose një përgatitje që përmban një ose më shumë substanca aktive, të vënë në dispozicion te shfrytëzuesit dhe të destinuar për të:

- 2.1.1. mbrojtur bimët ose produktet bimore nga organizmat e dëmshëm ose për parandalimin e veprimit të organizmave të tillë, për aq sa substanca ose përgatitjet nuk janë të përcaktuar ndryshe;
- 2.1.2. ndikuar në proceset jetësore të bimëve, përveç si një lëndë ushqyese (p.sh. rregullator për rritje të bimëve);
- 2.1.3. ruajtur produktet bimore, për aq sa substanca ose produkte të tilla nuk i nënshtrohen dispozitave të veçanta mbi mjetet për ruajtje;
- 2.1.4. shkatërrojë bimët e padëshiruara ose pjesët e bimëve, të kontrollojnë ose parandalojnë rritjen e padëshirueshme e bimëve.
- 2.2. substancë - elementi kimik ose komponimet e tij, qoftë nëse ato ndodhin natyrshëm, ose me prodhim, përfshirë çdo papastërti në mënyrë të pashmangshme që rezulton nga procesi i prodhimit;
- 2.3. substanca aktive – substanca ose mikroorganizmi, duke përfshirë edhe viruset, që ka veprime të veçanta ose të përgjithshme ndaj organizmave të dëmshëm, në bimë, pjesë të bimëve ose produkteve.
- 2.4. përgatitje - përzierja apo tretësira e përbërë nga dy ose më shumë substanca, prej të cilave të paktën njëra është substancë aktive, të destinuara për përdorim si produkt për mbrojtjen e bimëve;
- 2.5. bimë - bima e gjallë dhe pjesa e bimës së gjallë, përfshirë edhe frutat e freskëta dhe farat;
- 2.6. produkt bimore - produkti në gjendje të papërpunuar ose që ka pësuar vetëm përgatitje të thjeshta si bluarje, tharje ose ndrydhje, që rrjedhin nga bimët, por duke përjashtuar vetë bimët siç përcaktohet në nën-paragrafin 2.5 të këtij paragrafi;
- 2.7. organizmat e dëmshëm – dëmtuesi i bimëve ose produkteve bimore që i përkasin botës bimore dhe shtazore siç janë viruset, bakteriet dhe mikroplazmat dhe patogjenët e tjerë;
- 2.8. produkt - substanca aktive siç përcaktohet në nën-paragrafin 2.3 të këtij paragrafi, apo kombinimin e substancave aktive të një produkti për mbrojtjen e bimëve;
- 2.9. patentë bazë - patenta e që mbron një produkt si të tillë, preparatin, procesin për të përftuar produktin ose aplikimin e një produkti i cili caktohet nga pronari i tij për procedurën e dhënies së certifikatës suplementare;
- 2.10. autorizimi i parë për të vendosur në treg - autorizimi i parë për vendosjen e produkteve si produkte për mbrojtjen e bimëve në treg në Republikë apo në Bashkimin Evropian.

### **Neni 85 Kohëzgjatja e certifikatës**

1. Certifikata jepet në përputhje me dispozitat e këtij ligji në rastet kur një patentë bazë është dhënë për një produkt i cili është pjesë përbërëse e një produkti medicinal i destinuar për njerëzit apo kafshët, ose për një produkt për mbrojtjen e bimëve, për t'u vendosur në treg i cili kërkon autorizimin paraprak nga organi shtetëror kompetent.
2. Certifikata hynë në fuqi menjëherë pas skadimit të afatit ligjor të patentës bazë.

3. Të drejtat e fituara me certifikatë vazhdojnë për një periudhë të barabartë me kohën e kaluar në mes të datës së dorëzimit të aplikimit për një patentë bazë dhe datës së autorizimit të parë në vendin e produktit të mbrojtura nga një patentë të tillë në treg, të reduktuar në një periudhë prej pesë (5) vjetësh.

4. Kohëzgjatja e Certifikatës nuk mund të kalojë mbi pesë (5) vjet nga data në të cilën ajo hyn në fuqi.

5. Periudha e përcaktuar në paragrafët 3. dhe 4. të këtij neni zgjatet për gjashtë (6) muaj për rastet në të cilat zbatohet neni 36 i Rregullores (EC) Nr 1901/2006. Në këtë rast kohëzgjatja e periudhës së përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni mund të zgjatet vetëm një herë.

6. Kohëzgjatja e certifikatës përcaktohet me vendim të lëshuar nga Zyra.

### **Neni 86 Kushtet për marrjen e certifikatës**

1. Certifikata jepet me kërkesë të pronarit të patentës bazë, në datën e dorëzimit të aplikimit për certifikatë, me kusht që të jenë përmbushur kushtet në vijim:

1.1. që produkti mbrohet nga patenta bazë në fuqi;

1.2. që autorizimi është dhënë në pajtueshmëri me rregulloret specifike, i cili është ende në fuqi për vendosjen e produktit në treg, si produkt mjekësor i destinuar për njerëz ose kafshë, respektivisht produkt për mbrojtjen bimore;

1.3. që produkti nuk ka qenë më parë subjekt i certifikatës;

1.4. që autorizimi sipas nën-paragrafit 1.2. të këtij paragrafi është autorizimi i parë për të vendosur në treg një produkt si produkt mjekësor i destinuar për njerëzit ose kafshët, respektivisht produkt për mbrojtjen e bimëve.

### **Neni 87 Aplikimi për certifikatë**

1. Aplikacioni për certifikatë dorëzohet në Zyrë, brenda gjashtë (6) muajve nga data e dhënies së autorizimit, sipas nenit 86 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. të këtij ligji dhe nëse autorizimi është dhënë para dhënies së patentës bazë, brenda gjashtë (6) muajve nga data e lëshimit të vendimit sipas nenit 80 paragrafi 2. të këtij ligji.

2. Aplikacioni për kohëzgjatjen e afatit të përmendur në paragrafin 5. të nenit 85 të këtij ligji mund të bëhet kur parashtrahet aplikacioni për certifikatë ose kur aplikacioni për certifikatë është ende i pa zgjidhur dhe plotësohen kushtet e përcaktuara në paragrafin 4. apo paragrafin 5. të nenit 88 aplikacioni për kohëzgjatje të afatit të certifikatës së dhënë mund të parashtrahet jo më vonë se dy (2) vite para mbarimit të afatit të certifikatës.

### **Neni 88 Përmbajtja e aplikacionit për certifikatë**

1. Aplikacioni për certifikatë përveç kërkesës për dhënie të certifikatës përmban në veçanti:

1.1. emrin dhe adresën e aplikuesit;

1.2. emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar, nëse ka të tillë;

1.3. numrin e patentës bazë dhe titullin e shpikjes;



1.4. numrin dhe datën e autorizimit të parë për të vendosur produktin në treg, ose të ceket se numri dhe data e autorizimit të parë, nëse autorizimi ashtu siç është dorëzuar nuk është autorizimi i parë për të vendosur produktin në treg;

1.5. kopjen e autorizimit për të vendosur produktin në treg, në të cilin identifikohet produkti dhe i cili përmban në veçanti numrin, datën e autorizimit dhe përmbledhjen e karakteristikave të produktit të lëshuar nga autoriteti kompetent në procedurat e përcaktuara me akte nënligjore;

1.6. dëshminë që tregon identitetin e produktit, përmbajtjen e procedurës së autorizimit dhe buletinin në të cilin është publikuar e dhëna lidhur me autorizimin, nëse autorizimi sipas nën-paragrafit 1.2. të këtij paragrafi nuk është autorizimi i parë për të vendosur produktin në treg;

1.7. dëshminë për pagesën e tarifës për dhënie të certifikatës si dhe për zgjatje të afatit të certifikatës.

2. Nëse aplikuesi për certifikatë është pronar i më shumë se një patente të të njëjtit produkt, atij i jepet vetëm një certifikatë për atë produkt.

3. Nëse dy ose më shumë aplikime kanë të bëjnë me të njëjtin produkt dhe burojnë nga dy apo më shumë pronarë të patentave të ndryshme, secilit pronar mund t'i jepet nga një certifikatë për këtë produkt.

4. Kur në aplikacionin për certifikatë përfshihet kërkesa për zgjatje të afatit:

4.1. kërkohet kopja e deklaratës në të cilën tregohet pajtueshmëria me planin e kompletuar të kërkimeve pediatrike siç është cekur në nenin 36 (1) të Rregullores (EC) Nr.1901/2006;

4.2. përveç kopjes së autorizimit për të vendosur produktin në treg mund të kërkohet edhe dëshmia e posedimit të autorizimit e të gjitha shteteve anëtare për të vendosur produktin në tregun.

5. Kur aplikacioni për certifikatë është në fazën e ekzaminimit, kërkesa për kohëzgjatje të afatit sipas paragrafit 2. të nenit 87 të këtij ligji duhet të përmbajë kushtet e cekura në paragrafin 4. të këtij neni.

6. Kërkesa për kohëzgjatjen e afatit të certifikatës së dhënë duhet të përmbajë kushtet e cekura në paragrafin 4. të këtij neni dhe kopjen e certifikatës.

7. Kërkesat e cekura në paragrafin 1. të këtij neni përcaktohen me akt nënligjor.

### **Neni 89 Ekzaminimi formal**

1. Zyra kryen ekzaminim formal në momentin e dorëzimit të aplikimit për certifikatë.

2. Me ekzaminim formal konstatohet nëse:

2.1. aplikimi është dorëzuar në formën e duhur dhe nëse përmban të gjithë treguesit sipas paragrafit 1. neni 88 të këtij ligji;

2.2. është bërë pagesa e tarifës sipas paragrafit 1. nën-paragrafit 1.7. të nenit 88 të këtij ligji.

2.3. aplikimi është dorëzuar brenda periudhës së paraparë me nenin 87 të këtij ligji;

2.4. aplikimi shoqërohet me dëshminë e cekur në paragrafin 1. nën-paragrafët 1.4, 1.5, 1.6 dhe paragrafi 4. të nenit 88, të këtij ligji;

2.5. patenta bazë ka qenë në fuqi në kohën e dorëzimit të aplikacionit për certifikatë.

3. Nëse aplikimi për certifikatë nuk përmban elementet e cekura në paragrafin 2. të këtij neni, zyra njofton aplikuesin që të korrigoj mangësitë brenda periudhës tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i njoftimit.

4. Nëse aplikuesi nuk korrigoj mangësitë e cekura në njoftim, brenda afatit të përcaktuar kohor, Zyra do të nxjerr vendimin për refuzimin e aplikimit për certifikatë.

5. Nëse aplikuesi plotëson mangësitë brenda afatit sipas paragrafit 2. të këtij neni, Zyra vazhdon procedurën.

6. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për kërkesat për kohëzgjatjen e afatit.

### **Neni 90** **Procedura e ekzaminimit substancial**

1. Zyra me ekzaminim substancial shqyrton nëse:

1.1. kushtet për marrjen e certifikatës të cekura në nenin 86 të këtij ligji janë përmbushur në datën e dorëzimit të kërkesës;

1.2. produkti për të cilin aplikohet për certifikatë është i mbrojtur nga patenta bazë;

1.3. autorizimi për vendosjen e produktit në treg është dhënë në mënyrën siç është përcaktuar me rregullore të veçantë;

1.4. produkti tashmë është lëndë e certifikatës.

2. Nëse Zyra konstaton se janë plotësuar kushtet e parapara lëshon vendimin për dhënien e certifikatës.

3. Nëse, Zyra konstaton se nuk janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara, refuzon kërkesën për certifikatën me vendim.

4. Paragrafët 1. deri 3. të këtij neni zbatohen edhe për aplikacionet e kohëzgjatjes së afatit.

### **Neni 91** **Përmbajtja e certifikatës**

1. Certifikata përmban:

1.1. emrin, adresën e bartësit të certifikatës;

1.2. numrin e patentës bazë;

1.3. titullin e shpikjes;

1.4. numrin dhe datën e autorizimit për të vendosur produktin në treg, emrin e produktit të identifikuar në autorizim;

1.5. numrin dhe datën e autorizimit të parë për të vendosur produktin në treg, sipas nevojës, bazuar në dispozitat e nenit 88 paragrafit 1. nën-paragrafit 1.5. të këtij ligji;

1.6. kohëzgjatjen e certifikatës.

### **Neni 92** **Regjistrimi i të dhënave në regjistër**

Të dhënat nga certifikata regjistrohen në Regjistrin e Zyrës të cilat përcaktohen me akt nënligjor.

### **Neni 93** **Lënda dhe efekti i mbrojtjes**

1. Brenda kufijve të mbrojtjes së dhënë nga patenta bazë, mbrojtja e dhënë me certifikatë ka efekt vetëm për produktin e mbuluar nga autorizimi për vendosjen e tij në treg.
2. Certifikata i njetet pronarit të patentës bazë ose pasardhësit të tij të drejtat dhe obligimet të njëjta nga patenta bazë.

### **Neni 94** **Publikimi**

Zyra publikon të dhënat e kërkesës për certifikatë, vendimin për dhënien ose refuzimin e certifikatës dhe përfundimin e saj të cilat përcaktohen me akt nënligjor.

### **Neni 95** **Vlefshmëria e certifikatës**

1. Certifikata vlen për periudhën për të cilën është dhënë.
2. Certifikata do të përfundoj para skadimit të periudhës për të cilën është dhënë nëse:
  - 2.1. mbajtësi i certifikatës dorëzon deklaratë me shkrim në Zyrë, që heq dorë nga certifikata e cila miratohet menjëherë;
  - 2.2. tarifa vjetore për mirëmbajtjen e së cilës nuk është paguar në afatin e caktuar kohor;
  - 2.3. produkti për të cilën është dhënë certifikata nuk është më në treg si rezultat i tërheqjes së autorizimit për ta plasuar atë në treg në pajtim me rregullat kombëtare.
3. Zyra vendos për skadimin e certifikatës sipas detyrës zyrtare, ose me kërkesën e personit të interesuar.

### **Neni 96** **Shpallja e pavlefshmërisë së certifikatës suplementare**

1. Certifikata shpallet e pavlefshme dhe të anulohet nëse:
  - 1.1. është dhënë kundër dispozitave të këtij ligji;
  - 1.2. patenta bazë ka skaduar sipas dispozitave të neneve 98, 100, dhe 106 të këtij ligji;
  - 1.3. patenta bazë është shpallur e pavlefshme apo është anuluar tërësisht ose pjesërisht, me ç'rast produkti për të cilën është dhënë certifikata, nuk do të mbrohet më tutje nga kërkesa e patentës bazë apo nëse ka përfunduar afati i vlefshmërisë së patentës.
2. Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me procedurën lidhur me kërkesën për shpalljen pavlefshmërisë së patentës, zbatohen edhe për procedurën për shpalljen e anulimit të certifikatës.

**KREU XIII  
PUSHIMI I EFEKTIT TË PATENTËS**

**Neni 97  
Pushimi i efekteve**

1. Patenta e dhënë pushon së qeni në fuqi:
  - 1.1. me skadimin e afatit për mbrojtje sipas nenit 82 të këtij ligji;
  - 1.2. për shkak të mos-pagesës së tarifës vjetore të mirëmbajtjes;
  - 1.3. në bazë të dorëzimit apo heqjes dorë;
  - 1.4. në bazë të shpalljes së pavlefshmërisë.
2. Përfundimi i efekteve të patentës regjistrohet në regjistër dhe publikohet.

**Neni 98  
Mospagesa e tarifës vjetore të mirëmbajtjes**

Nëse aplikuesi për patentë ose pronari i patentës nuk paguan tarifat për mirëmbajtjen vjetore të të drejtave të patentës sipas nenit 83 të këtij ligji, patenta përfundon ditën e skadimit të afatit të pagesës.

**Neni 99  
Dorëzimi i patentës**

1. Pronari i patentës mund të dorëzojë patentën tërësisht ose pjesërisht, me deklaratë me shkrim. Deklarimi i dorëzimit hyn në fuqi ditën e nesërme pas ditës që i komunikohet Zyrës.
2. Pronari i patentës nuk mund të dorëzojë patentën pa pëlqimin me shkrim të personave të tretë nëse ata kanë të regjistruar në regjistër ndonjë të drejtë mbi patentën.
3. Dorëzimi i patentës, regjistrohet në regjistër dhe publikohet në Buletinin Zyrtar.

**Neni 100  
Vdekja ose paaftësia ligjore e bartësit të së drejtës**

1. Patenta skadon në ditën e vdekjes së pronarit, respektivisht në ditën e humbjes së subjektivitetit juridik të personit juridik përpos nëse i bartet trashëgimtarit apo pasardhësit ligjor.
2. Paragrafi 1. i këtij neni zbatohet edhe për aplikimet për patentë.

**KREU XIV  
DEKLARATA E PAVLEFSHMËRISË SË PATENTËS**

**Neni 101  
Aplikimi për deklarin e pavlefshmërisë**

1. Procedura lidhur me shpalljen e pavlefshmërisë të patentës, iniciohet nga paraqitja e kërkesës pranë Zyrës.

2. Kërkesa nga paragrafi 1. i këtij neni përmban:

2.1. të dhënat lidhur me paraqitësin e aplikacionit,

2.2. numri i patentës kundër të cilit është dorëzuar aplikacioni, emrin e pronarit të patentës dhe titullin e shpikjes,

2.3. deklaratë e shkallës në të cilën patenta është propozuar të jetë pavlefshme dhe bazat mbi të cilat bazohet propozimi, si dhe cekja e fakteve dhe provave të paraqitura në mbështetje të këtyre bazave;

2.4. të dhënat lidhur me përfaqësuesin e autorizuar të patentave në qoftë se aplikacioni është dorëzuar nëpërmjet përfaqësuesit.

2.5. dëshminë për pagesën e tarifave administrative për aplikacionin për shpalljen e pavlefshmërisë, ashtu siç ceket në nenin 48 të këtij ligji.

#### **Neni 102**

#### **Arsyet për deklarimin e pavlefshmërisë**

1. Patentë shpallet e pavlefshme nëse është dhënë:

1.1. për një lëndë që nuk është e patentueshme brenda përkufizimit të neneve 7 deri 14 të këtij ligji;

1.2. për një shpikje e cila nuk është paraqitur në mënyrë mjaft të qartë dhe të plotë që do të mund të kryhet nga një person me njohuri në atë fushë;

1.3. për një shpikje e cila, në datën e dorëzimit të aplikacionit për patentë ose respektivisht në datën e përparësisë së dhënë, nuk ishte e re, ose nuk ka përfshirë shkallën e risisë, apo e cila nuk është e zbatueshme në industri;

1.4. për lëndën që del jashtë përmbajtjes së aplikacionit për patentën që është dorëzuar si e tillë, ose nëse patenta është dhënë për një aplikim me ndarje ose një aplikim të ri të dorëzuar sipas paragrafit 4. të nenit 111 të këtij ligji.

#### **Neni 103**

#### **Periudha për dorëzimin dhe personat që kanë të drejtë të shpallin pavlefshmërinë**

1. Deklarata e pavlefshmërisë së patentës mund të apelohehet në çdo kohë gjatë kohës së mbrojtjes me patentë, nga çdo person fizik ose juridik, ose ex-officio (sipas detyrës zyrtare) nga Zyra.

2. Procedura për shpalljen e pavlefshmërisë së patentës kryhet nga Zyra ose nëpërmjet Zyrës me Zyrat të cilat Zyra ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në këtë drejtim.

#### **Neni 104**

#### **Ekzaminimi i kushteve për shpalljen e pavlefshmërisë**

1. Kur propozimi për shpalljen e pavlefshmërisë së patentës nuk është bërë në përputhje me nenin 101 të këtij ligji, Zyra fton aplikuesin për të korrigjuar mangësitë brenda dy (2) muajve nga data e marrjes së njoftimit.

2. Nëse aplikuesi nuk korrigjon mangësitë e cekura në njoftim, brenda afatit kohor sipas paragrafit 1. të këtij neni, Zyra refuzon aplikacionin.

3. Zyra do të komunikojë një kopje të propozimit për shfuqizimin e patentës, së bashku me provat e dhëna, pronarit të patentës, duke kërkuar që ai të përgjigjet dhe bëjë ndryshimet, aty ku është e nevojshme në përshkrim, kërkesa patentore dhe vizatime brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e pranimit të njoftimit.

4. Zyra fton të dy palët, sa herë që është e nevojshme, të paraqesin vërejtjet e tyre në parashtrësit për kundërshtimet e palës kundërshtuese brenda afatit kohor të cekur në paragrafin 3. të këtij neni.

5. Të gjitha komunikimet me shkrim të autoritetit kompetent dhe përgjigjet e tyre dorëzohen të gjitha palëve në procedurë.

6. Me kërkesë të arsyeshme, Zyra mund të zgjasë afatet kohore të cekura në këtë nen për një periudhë që ajo e konsideron të arsyeshme, por e cila nuk duhet të tejkalojë gjashtëdhjetë (60) dite.

#### **Neni 105**

#### **Vendim lidhur me propozimin për shpalljen e pavlefshmërisë së patentës**

1. Zyra nxjerrë:

1.1. vendim për shpalljen e pavlefshmërisë së patentës, tërësisht ose pjesërisht, në qoftë se konstaton se kërkesat për dhënien e saj nuk janë plotësuar;

1.2. vendimi për refuzim të kërkesës nëse konstatohet se kërkesat për dhënie janë përmbushur.

2. Në qoftë se një patentë shpallet e pavlefshme të gjitha efektet ligjore të dhënë nga ajo patentë janë të pavlefshme.

3. Para se të merret vendimi për deklarimin e patentës në pjesë, zyra njofton palët për tekstin e patentës të cilat do të mbesin në patentë dhe i fton ata që të paraqesin vërejtjet e tyre brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nëse ata nuk pajtohen për atë tekst. Nëse palët nuk pajtohen me atë tekst, procedura për deklarim të pavlefshmërisë mund të zgjatet.

4. Nëse palët pajtohen me tekstin të cilin Zyra propozon për patenta, ose palët nuk i përgjigjen risisë sipas paragrafit 3 të këtij neni, Zyra fton pronaret e patentave për të paguar taksën administrative në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditëve që nga dita e pranimit të njoftimit për ri-lëshimin e përshkrimit të detajuar të patentës. Nëse taksa nuk paguhet me kohë, patenta duhet të shpallet e pavlefshme dhe anulohet me kërkesë të deklaratës se jo-validitetit.

5. Zyra publikon të dhënat për patentën e pavlefshme në Buletinin Zyrtar brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data e vendimit përfundimtar.

#### **KREU XV**

#### **ANULIMI I VENDIMIT PËR DHËNIEN E PATENTËS**

#### **Neni 106**

#### **Bazat për anulimi**

1. Vendimi për dhënien e patentës në fuqi mund të anulohet për të ardhmen para skadimit të afatit të patentës, në qoftë se është vendosur:

1.1. qe materiali biologjik praktik i depozituar në institucionin e autorizuar në pajtim me dispozitat e cekura në nenin 55 paragrafi 2. të këtij ligji nuk ekziston më ose materiali i cekur nuk është më në dispozicion të publikut;

1.2. qe është në dispozicion të publikun përmes institucionit të autorizuar në të cilat ajo ka qenë e depozituar u ndërpritet në periudhën më të gjatë se sa është paraparë.

#### **Neni 107** **Kërkesa për anulim**

1. Procedura për anulimin e vendimit për dhënien e patentës fillon me dorëzimin e kërkesës për anulim në Zyrë.

2. Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me përmbajtjen e aplikacionit dhe me procedurën e shpalljes së pavlefshme të patentës zbatohen me ndryshimet e nevojshme, edhe në përmbajtjen e aplikacionit dhe procedurën lidhur me anulimin e vendimit për dhënie të patentës.

### **KREU XVI** **SHËRBIMET INFORMUESE TË ZYRËS SË PRONËSISË INDUSTRIALE**

#### **Neni 108** **Fshehtësia e lëndës dhe shërbimet e informimit**

1. Lënda e aplikacioneve për patenta dhe patentat të cilat ende nuk janë publikuar në Buletinin Zyrtar nuk vihen në dispozicion të publikut pa pëlqimin e aplikuesit.

2. Zyra në bazë të kërkesës vë në disponim të çdo personi fizik ose juridik kopje të aplikacionit për patentë të publikuar në Buletinin Zyrtar.

3. Para publikimit të aplikacionit për patentë në Buletinin Zyrtar, Zyra mund t'i bëjë të njohur çdo personi fizik ose juridik të dhënat si: numrin e aplikacionit, datën e regjistrimit ose në rastin e përparësisë kërkesën për këtë, numrin, datën dhe vendin ose organizatën ku është dorëzuar aplikacioni i parë, informata për aplikuesin dhe titullin e shpikjes.

4. Tarifa për ofrimin e këtyre shërbimeve përcaktohet me akt nënligjor.

#### **Neni 109** **Ekstrakti nga Regjistri**

1. Zyra lëshon ekstrakt nga Regjistri i Patentave me kërkesën e çdo personi fizik apo juridik i cili ka paguar tarifën përkatëse.

2. Mënyra e nxjerrjes, përmbajtja, si dhe pagesa për ekstraktin përcaktohen me akt nënligjor.

### **KREU XVII** **ZBATIMI**

#### **Neni 110** **Subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë mbrojtjen e patentës**

Përveç pronarit të së drejtës së patentës, të drejtën për mbrojtjen e patentës mund ta kërkojë edhe pronari i licencës ekskluzive deri në masën për të cilën ka të drejtën për përdorim të patentës në bazë të kontratës për licencën.

#### **Neni 111**

#### **Kërkesa për vendosjen e të drejtës për dhënie të Patentës**

1. Nëse aplikimi për patentë është dorëzuar nga një person që nuk ka të drejtë për dhënien e një patente për një shpikje, shpikësi përkatësisht trashëgimtari i tij ligjor, mund të kërkojë një veprim ligjor duke kërkuar caktimin e të drejtave të tij për dhënien e patentës.

2. Nëse aplikimi për patentë është dorëzuar nga një person i cili nuk ka të drejtë për atë dhe i cili është njëri nga personat që kanë krijuar së bashku shpikje, shpikësit e tjerë përkatësisht trashëgimtarët e tyre ligjor, mund të kërkojë caktimin e të drejtave të tyre në dhënien e përbashkët të patentës.

3. Shpikësi e drejta e të cilit për dhënien e një patente është caktuar me vendim të formës së prerë mund, në çdo kohë, të kërkojë nga Zyra për të regjistruar emrin e tij në aplikimin për patentë dhe të gjitha dokumentet e lëshuara për patentë, si dhe në regjistrat e tjerë relevant të Zyrës. Regjistrimi i emrit të shpikësit, të gjithashtu mund të kërkohet nga pasardhësi i tij ligjor.

4. Shpikësi ose pasardhësi i tij, të cilit, me vendim të gjykatës i është vendosur e drejta për dhënie të mbrojtjes së patentës për shpikje, ka të drejtë të rifillojë procedurën për dhënie të patentës brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data në të cilën është dhënë vendimi përfundimtarë i gjykatës ose të dorëzojë një aplikacion të ri për të njëjtën shpikje duke kërkuar datën e dorëzimit dhe datën e përparësisë të aplikacionit të dorëzuar nga aplikuesi i cili nuk ka të drejtën për marrje të patentës.

5. Shpikësi, e drejta për dhënie të pacetës të së cilit është vendosur me vendimin përfundimtar të gjykatës, në çdo kohë mund të kërkojë nga Zyra regjistrimin e emrit të tij në aplikacionin për patentë dhe në të gjitha dokumentet e lëshuara për patentë si dhe në regjistrat përkatës të zyrës. Regjistrimi i emrit të shpikësit mund të kërkohet po ashtu edhe nga pasardhësi i tij ligjor.

#### **Neni 112**

#### **Kërkesa për shkak të shkeljes së të drejtës së emërimit të shpikësit**

1. Nëse personi i cili nuk është shpikës, është përmendur në aplikimin për patentë dhe në dokumente në lidhje me patentën ose në regjistrat e Zyrës, ose nëse shpikësi nuk është përmendur, shpikësi mund të iniciojë padi duke kërkuar t'i përmendet emrin i tij.

2. Nëse personi i cili nuk është shpikës, e është përmendur si i tillë në aplikimin për patentë dhe në dokumente në lidhje me patentën ose regjistrat e Zyrës, ndaj personit të tillë do të iniciohet padi.

3. E drejta për padi të cekur në paragrafin 1. të këtij neni duhet t'i përket edhe shpikësit të një shpikje të përbashkët dhe nuk do të trashëgohet.

4. Padia e cekur në paragrafin 1. të këtij neni mund të paraqitet në çdo kohë gjatë vlefshmërinë e patentës.

#### **Neni 113**

#### **Kërkesë për deklaram dhe ndërprerjen e shkeljes**

1. Pronari i patentës mund të iniciojë padi kundër çdo personi i cili ka shkelur patentën duke kryer pa autorizim ndonjëherë prej akteve të cekura në nenin 23 dhe nenin 24 të këtij ligji, që përbën shkelje.

2. Pronari i patentës mund të iniciojë padi kundër çdo personi i cili ka shkelur një patentë duke kryer pa autorizim ndonjëherë prej akteve të cekura në nenin 23 dhe nenin 25 të këtij ligji, duke kërkuar ndërprerjen e shkeljes dhe ndalimin e shkeljeve të tilla dhe të ngjashme në të ardhmen.



3. Pronari i patentës mund të inicioj padi kundër çdo personi që duke kryer ndonjë prej akteve pa autorizim ka shkaktuar kërcënim serioz se patenta e tij mund të jetë cenuar, duke kërkuar ndërprerje nga akti në fjalë dhe ndalimin e shkeljes së patentës.

4. Padia e cekur në këtë nen, mund të bëhet kundër personit që në rrjedhën e saj / tij të aktiviteteve ekonomike kryen shërbime që përdoren në aktet që cenojnë patentën ose kërcënojnë shkeljen e saj.

#### **Neni 114**

#### **Kërkesa për konfiskimin dhe shkatërrimin e objekteve**

1. Pronari i patentës mund të inicioj padi kundër çdo personi i cili ka shkelur patentën duke kryer pa autorizim ndonjë prej akteve të përmendura në nenin 23 dhe nenin 24 të këtij ligji, duke kërkuar që produktet që rrjedhin apo janë fituar me shkeljen e patentës, si dhe objektet, veglat dhe mjetet të përdorura kryesisht në prodhimin e produkteve që shkelin patentën, të hiqen nga tregu, konfiskohen apo të shkatërrohen me shpenzime e shkelësit.

2. Gjykata urdhëron masat e cekura në paragrafin 1. të këtij neni kundër të pandehurit, përveç nëse ka arsye të veçanta për të mos vendosur kështu.

3. Kur urdhëron masa sipas paragrafit 1. të këtij neni, gjykata do të kujdeset nëse ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe seriozitetin e shkeljes.

#### **Neni 115**

#### **Kërkesë për dëmet dhe kompensimi i zakonshëm dhe pasurimi i pabazë**

1. Pronari i patentës mund të ushtroj padi kundër çdo personi që i ka shkaktuar dëm atij duke kryer pa autorizim ndonjë prej akteve të cekura në nenin 23 dhe nenin 25 të këtij ligji, duke kërkuar që dëmet sipas rregullave të përgjithshme mbi korrigjimet ligjore të përcaktuara në Ligjin për detyrimet.

2. Pronari i patentës mund të ushtroj padi kundër çdo personi që ka kryer pa autorizim ndonjë prej akteve të cekura në nenin 23 dhe nenin 24 të këtij ligji, duke kërkuar pagesat e shpërblimit në shumën që ai do të kishte marrë, duke pasur parasysh rrethanat në marrëveshjen e licencës nëse është nënshkruar.

3. Pronari i patentës mund të ushtroj padi kundër çdo personi i cili ka shkelur patentën duke kryer pa autorizim ndonjë prej akteve të cekura në nenin 23 dhe nenin 24 të këtij ligji, pa pasur baza për atë në çdo transaksion ligjor, vendim të gjykatës ose sipas ligjit, dhe ka përfituar prej saj, duke kërkuar rikthim ose kompensimin e përfitimeve të tilla në pajtim me rregullat e përgjithshme mbi pasurimin e pabazë, të përcaktuara në Ligjin për detyrimet.

4. Kërkesat e cekura në paragrafët 1., 2. dhe 3. të këtij neni nuk përjashtohen reciprokisht. Kur vendoset për kërkesat e ngritura kumulative dhe të cekura në paragrafët 1., 2. dhe 3. të këtij neni, gjykata respekton parimet e përgjithshme të përcaktuara në Ligjin për detyrimet.

#### **Neni 116**

#### **Kërkesa për publikimin e aktgjykimit**

1. Pronari i patentës mund të kërkojë që aktgjykimi i gjykatës me të cilin vërtetohet shkelja e plotë apo e pjesshme e së drejtës së patentës, të publikohet në mjetet e informimit publik, me shpenzimet e personit të dënuar.

2. Gjykata vendos brenda kufijve të kërkesës për publikimin e tërësishëm ose pjesërisht të aktgjykimit dhe mjetin e informimit se ku do të bëhet publikimi.

3. Nëse Gjykata vendos që të publikohet vetëm një pjesë e aktgjykimit, ajo urdhëron, brenda kufijve të kërkesës, që të publikohet së paku pjesa e aktgjykimit ku është shqiptuar shkelja dhe kryerësi i saj.

### **Neni 117 Barra e provës**

1. Për qëllime të procedurës civile në lidhje me shkeljen e një procesi për marrjen e një produkti të mbrojtur me patentë, organet gjyqësore kanë autoritetin të urdhërojnë të pandehurin të provojë se procesi i fitimit të produktit të njëjtë, është i ndryshëm nga procesi i fitimit të produktit të patentuar.

2. Çdo produkt i njëjtë kur prodhohet pa pëlqimin e pronarit të patentës, në mungesë të provave në të kundërtën konsiderohet se është fituar nga procesi i patentuar:

2.1. në qoftë se produkti i fituar nga procesi i patentuar është i ri;

2.2. në qoftë se ka mundësi të konsiderueshme që produkti i njëjtë është bërë nga procesi dhe pronari i patentës nuk ka qenë në gjendje me përpjekje të arsyeshme të përcaktojë procesin që është përdorur në të vërtetë.

3. Barra e provës e cekur në paragrafin 1. të këtij neni mbetet e dyshuar, nëse është plotësuar vetëm njëra nga kushtet e cekura në paragrafin 2. të këtij neni, duke marrë parasysh interesat legjitime të të pandehurit në mbrojtjen e sekreteve të prodhimit të tij dhe të sekreteve të biznesit.

### **Neni 118 Ndërlidhja me patentë të dhënë pa prova për patentueshmërinë**

Kur padia është përgatitur në lidhje me shkeljen e një patente, gjykata ndërpret procedurën deri sa Zyra të lëshon vendim në pajtim me paragrafin 2. të nenit 79 të këtij ligji.

### **Neni 119 Kërkesa për informacione**

1. Pronari i patentës, i cili ka filluar procedurën për mbrojtjen e patentës në rastet e shkeljes, mund të kërkojë informacionet për origjinën dhe rrjetin e shpërndarjes së produkteve që shkelin patentën.

2. Kërkesa sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të paraqitet në formë të padisë ose për marrjen e masave të përkohshme kundër:

2.1. personit kundër të cilit është ngritur padi sipas paragrafit 1. të këtij neni;

2.2. personit i cili në kuadër të aktivitetit të tij afarist posedon produkte për të cilat ekziston dyshimi se kanë shkelur patentën;

2.3. personit i cili gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij afarist ofron shërbime, për të cilat dyshohet se shkelin patentën;

2.4. personave të cilët gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre afarist ofrojnë shërbime apo përdorin shërbimet e ofruara në aktivitetet e dyshuara që shkelin patentën;

2.5. personit për të cilin dëshmohej se është përfshirë në prodhimin ose shpërndarjen e produkteve ose ofrimin e shërbimeve të dyshuara që shkelin patentën.

3. Kërkesa për informacione për origjinën dhe rrjetin e shpërndarjes së produkteve dhe shërbimeve sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të përfshijë në veçanti:

3.1. informatat për emrat dhe adresat e prodhuesve, shpërndarësve, furnitorëve dhe pronarëve të tjerë të mëparshëm të produkteve dhe shërbimeve, shitësve me shumicë dhe pakicë;

3.2. informatat për sasinë e prodhuara, shpërndara, pranuar dhe porositura, si dhe çmimin për produktet dhe shërbimet.

4. Nëse personi në fjalë refuzon të ofrojë informacione pa arsye bindëse, personi është përgjegjës për dëmin e shkaktuar, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

5. Dispozitat e këtij neni nuk vlejnë për përdorimin e informacioneve të fshehta.

6. Dispozitat e këtij neni nuk vlejnë për dispozitat të neneve 121 dhe 122 të këtij ligji që rregullojnë marrjen e dëshmive.

#### **Neni 120**

#### **Masat e përkohshme në rast të shkeljes së patentës**

1. Pas kërkesës nga pronari i patentës, i cili dëshmon se patenta e tij është shkelur ose është kërcënuar të shkelet, gjykata mund të urdhërojë marrjen e masës së përkohshme me qëllim që t'i japë fund ose të parandalojë shkeljen dhe në veçanti:

1.1. të urdhëron palën kundërshtare të ndërpresë veprimet e shkeljes së patentës të lëshojë urdhër të tillë kundër ndërmjetësuesit, shërbimet e të cilit të përdorura nga pala e tretë shkelin patentën;

1.2. të urdhërojë konfiskimin ose heqjen nga tregu të produkteve të cilët janë në kundërshtim me këtë ligj.

2. Pas kërkesës nga pronari i patentës, i cili dëshmon se patenta e tij është shkelur në veprimtari afariste me qëllim të sigurimit të përfitimit material dhe shkelja përben kërcënim serioz për shkaktim të dëmit serioz dhe të riparueshëm ose vështirë të riparueshëm, gjykata përveç masave të përkohshme të cekura në paragrafin 1. të këtij neni, urdhëron konfiskimin e pasurisë së tundshme dhe të patundshme të palës kundërshtuese, e cila nuk është drejtpërdrejt e lidhur me shkeljen, duke përfshirë edhe ngjirjen e llogarive bankare dhe asetëve tjera.

3. Me qëllim të caktimit dhe ekzekutimit të masës së përkohshme sipas paragrafit 2. të këtij neni, gjykata mund të kërkojë nga pala kundërshtare ose personat e tjerë përkatës, paraqitjen e informacioneve bankare, financiare dhe informacioneve të tjera ekonomike, ose vënien në dispozicion të informacioneve dhe dokumenteve të tjerë në lidhje me to. Gjukata siguron mbrojtjen e konfidencialitetit të informacioneve të tilla dhe e ndalon shpërdorimin e tyre.

4. Masa e përkohshme sipas paragrafit 1. të këtij neni mund të urdhërohet pa informuar palën kundërshtare, nëse paditësi dëshmon se masat e tjera nuk do të ishin efektive, ose ekziston rreziku i shkaktimit të dëmit të riparueshëm ose vështirë të riparueshëm. Masa e përkohshme sipas paragrafit 2. të këtij neni mund të urdhërohet pa informuar palën kundërshtare, nëse paditësi, dëshmon se nuk do të ishte efektive ose, duke marrë parasysh rrethanat e rastit, kjo do të ishte e nevojshme.

5. Në vendimin për masën e përkohshme, gjykata cakton kohëzgjatjen e masës së tillë dhe nëse është urdhëruar ndonjë masë para fillimit të procedurës, periudhën brenda së cilës paditësi për masën inicion

procedurë për të arsyetuar masën, në afat prej njëzet (20) ditë pune dhe jo më e gjatë se tridhjetenjë (31) ditë kalendarike, nga data e shqiptimit të masës së përkohshme.

#### **Neni 121**

#### **Masat e përkohshme për ruajtjen e dëshmisë**

1. Sipas padisë së pronarit të patentës, i cili pohon se i është shkelur e drejta e patentës, ose kërcënohet të shkelet dhe ekziston mundësia që dëshmia e shkeljes ose kërcënimit në fjalë nuk mund të merret ose bëhet e vështirë të merret, gjykata me vendim urdhëron marrjen masës së përkohshme për ruajtjen e dëshmisë.

2. Përmes masës së përkohshme sipas paragrafit 1. të këtij neni, gjykata urdhëron:

2.1. përshkrimin e hollësishëm të produkteve dhe shërbimeve, të cilat mund të shkelin patentën me ose pa marrjen e mostrave;

2.2. konfiskimin e produkteve të cilat mund të shkelin patentën;

2.3. konfiskimin e materialeve dhe mjeteve të përdorura gjatë prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve që mund të shkelin patentën si dhe dokumentacionin që ka të bëjë me të.

3. Masa e përkohshme te cekura në paragrafin 1. të këtij neni, mund të urdhërohet pa njoftuar palën kundërshtare, nëse paditësi për marrjen e masës pohon se ekziston rreziku që dëshmia të shkatërrohet ose se mund të shkaktohet dëm i riparueshëm ose vështirë i riparueshëm.

4. Në vendimin që urdhëron masën e përkohshme, gjykata cakton kohëzgjatjen e masës edhe nëse procedura nuk është iniciuar, me kusht që kërkesa është paraqitur në afatin kohor i cili nuk do të jetë më i shkurtë se njëzet (20) ditë pune dhe jo më gjatë se tridhjetenjë (31) ditë kalendarike nga paraqitja e kërkesës.

#### **Neni 122**

#### **Sigurimi i dëshmive gjatë procedurës**

1. Kur pala në procedurën kërkon dëshmi që i përkasin palës kundërshtare, gjykata e urdhëron palën kundërshtare ti paraqesë dëshmitë e tilla brenda afatit të caktuar kohor.

2. Pronari i patentës në cilësinë e paditësit, i cili pretendon se shkelja e patentës është kryer në veprimtari afariste me qëllim të përfitimit material dhe për këtë paraqet dëshmi gjatë procedurës: si dokumente bankarë, financiare ose dokumente të tjera afariste apo dëshmi që pohojnë se ato i përkasin palës kundërshtare, gjykata e fton palën kundërshtare të paraqesë dëshmitë e tilla brenda afatit të caktuar kohor.

3. Nëse pala e ftuar refuzon që të paraqesë dëshmitë pasi që është njoftuar nga gjykata, gjykata ndërmerri masa për marrjen e dëshmive dhe vërtetimin e fakteve.

4. Dispozitat e Ligjit për Procedurën Civile që kanë të bëjnë me refuzimin e paraqitjes së dëshmive si dëshmitar, zbatohet mutatis mutandis për të drejtën e palës për të refuzuar të paraqesë dëshmi.

5. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit gjykata vendosë sipas bindjes se vetë për rëndësinë e faktit se pala që ka prova refuzon të pajtohet me vendimin e gjykatës, duke e urdhëruar atë që të paraqesë dëshmi, ose e mohon, se ajo ka dëshmi, në kundërshtim me mendimin e gjykatës.

6. Kundër vendimit të gjykatës të cekur në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, nuk lejohet apel i veçantë.

#### **Neni 123**

#### **Procedurat e shpejta dhe zbatimi i dispozitave të ligjeve të tjera**

1. Procedura në lidhje me shkeljen e patentës duhet të jetë e përshpejtuar.
2. Gjatë procedurës në lidhje me shkeljen e të drejtës së patentës zbatohen edhe dispozitat e ligjeve tjera në fuqi.
3. Me kërkesë të gjykatës ose të palës që ka iniciuar procedurën për shkeljen e së drejtës së patentës, Zyra pranon kërkesën për anulimin apo shpalljen e pavlefshëm të vendimit për patentën e regjistruar, të paraqitur para ose gjatë procedurës dhe do të veproj në procedurë të shpejtë. Gjykata duke marrë parasysh rrethanat vendos ndërprerjen e procedurës deri te vendimi përfundimtar.

**Neni 124**  
**Gjykatat kompetente**

Për të gjitha rastet e shkeljes së të drejtave të patentave vendos gjykata kompetente sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**KREU XVIII**  
**DISPOZITAT NDËSHKUESE**

**Neni 125**  
**Dispozitat ndëshkuese**

1. Me gjobë në shumë prej tremijë (3000) deri në pesëmijë (5000) Euro ndëshkohet personi juridik i cili gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij tregtare, në çfarëdo forme përdor produkte apo shërbime në të cilat përfshihet ose zbatohet patenta në kundërshtim në nenin 23 të këtij ligji.
2. Me gjobë në shumë prej njëmijë (1000) deri tremijë (3000) Euro ndëshkohet personi përgjegjës i personit juridik sipas paragrafit 1. i këtij neni.
3. Me gjobë në shumë prej dyqind (200) deri në tetëqind (800) Euro ndëshkohet personi fizik i cili gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij tregtare, në çfarëdo forme përdor produkte apo shërbime në të cilat përfshihet ose zbatohet patenta në kundërshtim në nenin 23 të këtij ligji.
4. Me gjobë në shumë prej njëmijë (1000) deri tremijë (3000) Euro ndëshkohet personi juridik, i cili e shfrytëzon licencën në kundërshtim me dispozitat e nenit 31 të këtij ligji.
5. Me gjobë në shumë prej njëmijë (1000) deri tremijë (3000) Euro ndëshkohet personi përgjegjës në personin juridik, i cili e shfrytëzon licencën në kundërshtim me dispozitat e nenit 31 të këtij ligji.
6. Me gjobë në shumë prej njëmijë (1000) deri tremijë (3000) Euro ndëshkohet personi fizik, i cili e shfrytëzon licencën në kundërshtim me dispozitat e nenit 31 të këtij ligji.
7. Në rastet kur patenta përdoret në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, me të cilin supozohet se është kryer vepër penale, zbatohen dispozitat e Kodit Penal të Kosovës.

**KREU XIX**  
**PËRFAQËSIMI**

**Neni 126**  
**Çështjet e përgjithshme të përfaqësimit**

1. Vetëm personi që është regjistruar në regjistrin e përfaqësuesve të patentave, i cili mbahet dhe mirëmbahet nga Zyra ka të drejtë të veprojnë para Zyrës.

2. Për të hyrë në regjistrin e përfaqësuesve të patentës paguhet taksa siç përcaktohet me aktin nënligjor.
3. Përfaqësuesi autorizohet me shkrim si përfaqësues për patenta dhe marka tregtare.
4. Çështjet e përfaqësimit përcaktohen më akte nënligjore.

### **Neni 127 Përfaqësimi**

1. Personi fizik apo juridik që nuk e ka vendin kryesor të biznesit, të vendbanimit ose qëndrimit të përhershëm në territorin e Republikës së Kosovës përfaqësohet para Zyrës nga një përfaqësues i regjistruar në Regjistrin e Përfaqësuesve të mbajtur nga Zyra, në qoftë se çështja e përfaqësimit nuk është paraparë ndryshe me ligj.

2. Si përjashtim nga dispozitat e cekura në paragrafin 1. të këtij neni, personat fizik apo juridik të huaj mund individualisht, pa një përfaqësues, të kryejë veprimet e mëposhtme:

2.1. dorëzoj aplikimin për patentë;

2.2. kryej akte të tjera që lidhen me përcaktimin e datës së dorëzimit të aplikacionit për patentë;

2.3. dorëzojë kopjen e vërtetë të aplikimit për patentën e parë, kur kërkohet e drejta për përparësi e cekur në nenin 64 të këtij ligji;

2.4. merr nga Zyra njoftimet në lidhje me procedurat e cekura në nën-paragrafët 2.1., 2.2. dhe 2.3. të paragrafit 2. të këtij neni.

2.5. paguaj taksat administrative të cekura në nenin 48 të këtij ligji.

3. Në rastin e kryerjes së akteve individuale, të cekura në paragrafin 2. të këtij neni, një person fizik apo juridik i huaj duhet të njoftoj në Zyrë për adresën, korrespondencë, e cila do të jetë në territorin e Republikës së Kosovës.

4. Nëse një person fizik apo juridik i huaj nuk arrin të emërojë një përfaqësues, ose të njoftoj zyrën për adresën, korrespondencë, sipas dispozitave të cekura në paragrafin 3. të këtij neni, Zyra do të ftoj atë me shkrim, që të emëroj një përfaqësues apo të njoftoj për adresën, korrespondencë brenda nëntëdhjetë (90) ditëve.

5. Nëse një person fizik apo juridik i huaj nuk i përgjigjet ftesës së Zyrës të cekur në paragrafin 4. të këtij neni, Zyra do të refuzojë komunikimin e tij me vendim dhe përfaqësuesi konsiderohet se nuk është emëruar.

6. Personin fizik apo juridik që ka vendin kryesor të biznesit, të vendbanimit ose qëndrimit të përhershëm në territorin e Republikës së Kosovës mund të përfaqësohet në procedurat para Zyrës nga një punonjës që nuk ka nevojë të jetë përfaqësues i patentës i regjistruar në regjistrin e përfaqësuesve.

### **Neni 128 Personat që kanë të drejtë të jenë përfaqësues për patenta**

1. Përfaqësuesi i patentave ka të drejtë të përfaqësoj palët në procedurë që kanë të bëjnë me njohjen dhe mirëmbajtjen e patentave dhe certifikatave për mbrojtje shtesë në pajtim me këtë ligj.

2. Përfaqësuesi i patentave mund të bëhet:

2.1. personi fizik, banor në Republikën e Kosovës, me studime të përfunduara universitare duke dhënë provimin kualifikues për një përfaqësues patente në Zyrë;

2.2. personat juridik, që kanë vendin kryesor të biznesit në Republikën e Kosovës dhe të punësuar së paku një person që plotëson kushtet e cekura në nën-paragrafin 2.1. të këtij paragrafi.

## **KREU XX DIZPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 129 Procedurat e pazgjidhura**

Të gjitha procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji të cilat janë të pazgjidhura për njohjen e patentave, procedurat lidhur me anulimet e patentave dhe procedurat lidhur me aplikimet për njohjen e patentave të rivaliduara bëhen në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

### **Neni 130 Ndryshimet e këtij ligji në ditën e hyrjes së Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian**

Në paragrafin 1. të nenit 29 fjalët " Republika e Kosovës" do të zëvendësohet me fjalët "të Bashkimit Evropian, pra Zona Ekonomike Evropiane", në ditën e hyrjes së Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian.

### **Neni 131 Zbatimi i dispozitave të cekura nga neni 38 deri në nenin 46 dhe neni 84 deri në nenin 96 të këtij ligji**

1. Zbatimin e dispozitave të cekura nga neni 38 deri në nenin 46 dhe neni 84 deri në nenin 96 të këtij ligji, do të fillojë të zbatohen në ditën e pranimit të Republikës në Bashkimin Evropian.

2. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, për zbatimin e këtij ligji nxjerr akte nënligjore, në afat prej dymbëdhjetë (12) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

### **Neni 132 Dispozita shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji shfuqizohet Ligji Nr.2004/49 "për Patentim", Ligji Nr.02L/100 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2004/49 "Për Patentim", si dhe aktet tjera që janë në kundërshtim me këtë ligj.

### **Neni 133 Hyrja në fuqi e këtij ligji**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-029  
29 korrik 2011**

**Shpallur me dekretin Nr.DL-016-2011, datë 09.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës  
Atifete Jahjaga.**